- TVSH ka bazë të gjerë tatimore dhe përcillet në të gjitha fazat e ciklit të prodhimit, shpërndarjes dhe tregtisë së mallrave dhe shërbimeve,
- Ngarkohet konsumatori i fundit,
- Favorizon prodhuesit dhe investitorët,
- TVSH përfshin një numër më të madhë të tatimpaguesve,
- TVSH ka mbrojtje më të mirë nga evazioni fiskal i mundshëm,
- TVSH funksionon me metodën e zbritjes dhe teknika e llogaritjes dhe arkëtimit ndikojnë në evitimin e të tatuarit të dyfishtë të qarkullimit mallrave dhe shërbimeve në të gjitha fazat e prodhimit, shpërndarjes dhe të tregtisë,
- TVSH stimulon eksportin,
- TVSH lehtëson funksionimin e suksesshëm të sistemit tatimor,

Nga arsyet e mësipërme rezulton se, TVSH në raport me të gjitha tatimet e tjera është tatimi me i rëndësishëm dhe mekanizmi më me ndikim në teorinë dhe praktikën

tatimore me të cilën realizohet funksionimi i suksesshëm dhe i qëndrueshëm i sistemit tatimor në ekonominë e çdo vendi.

TVSH në praktikë paraqet një laramani të madhe në lidhje me bazën e tatimit dhe rangut të aktiviteteve ekonomike mbi të cilat aplikohet tatimi. Edhe pse është kjo shumëllojshmëri në strukturën e TVSH-së dhe mënyrën e implementimit të saj ekziston një pajtim mbi disa çështje thelbësore.

E para është se përfundimi e jep sigurinë se baza finale e tatimit është konsumi, TVSH-ja e tillë kërkon që tatimi mbi mallrat kapitale të kreditohet, nuk ndryshon çmimet që prodhuesi i hasë në blerjen dhe shitjen nga njëri tjetri dhe në përputhje me këtë ka veçori të dëshirueshme të mbrojnë prodhimin (kështu që tatimi nuk e qon ekonominë drejt kufizimit të prodhimit), duke pasur parasysh se vihet mbi secilën fazë të prodhimit duke siguruar që TVSH të mbartet vetëm mbi konsumin.⁴⁹

TVSh-ja është tatim mbi konsumin (qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve). Ai mblihet nga personat që janë të regjistruar për këtë lloj tatimi nëpërmjet kryerjes së furnizimeve të ndryshme që i bëjnë konsumatorit duke përfshirë furnizimin e mallrave dhe shërbimeve .

Çdo person i tillë në qarkullimin që kalon malli apo shërbimi nga burimi i furnizimit dhe deri të konsumatori i fundit vendoset një vlerë e shtuar e cila mblihet nga shitësi për llogari të shtetit.

Konsumatori i fundit është ai që kryen qarkullimin final me shumën e vlerave të shtuara furnizimit që ai ka blerë në çdo hap që ka kaluar furnizimi.

TVSH-ja është formë e tatimit me të cilën tatohet vlera të cilën shitësi e ka shtuar në çmimin e shitblerjes të prodhimit dhe të shërbimeve në secilën fazë të ciklit të

⁴⁹ Embrill, Keen, Bodin and Perry, The Modern VAT, IMF: Washington DC, 2001, fq. 101

qarkullimit. Baza e TVSH-së është diferenca ndërmjet çmimit furnizues dhe çmimit të shitjes.

Pra, Tatimi mbi Vlerën e Shtuar - është tatim mbi konsumin, të cilin në mënyrë indirekte e paguan konsumatori përmes bizneseve, të cilat në fakt kanë rolin e agentëve ndërmjetësues. TVSH-ja është një tatim që mbledhet me anë të metodës së vetë deklarimit. Përsoneat e regjistruar dhe që paguajnë TVSH deklarojnë në organët tatimore shumën e TVSH-së që kanë për ta paguar dhe janë organët tatimore nëpërmjet kontrollit që verifikojnë nëse deklarimi ka qënë i saktë.

Mënyra e llogaritjes së TVSH-së është mundësia më e pakët për evazion fiskal. Mes atij që lëshon një faturë TVSH-je dhe atij që blen një mall me TVSH krijohen intëresa të kundërta. Përsonei që blen mallra mbi të cilat aplikohët TVSH-ja është i intëresuar t'i deklarojë këto blerje, pasi kjo TVSH në blerje i rimbursohet atij.

Për t'a përcaktuar TVSH-në që duhet të paguaj, firmës i duhet të mbledhë totalin e TVSH-së në faturat e saj të shitjes, dhe këtëj totali i zbret totalin e TVSH-së në faturat e saj të blerjes. Totali i TVSH-së në shitje quhet edhe tatimi bruto ose TVSH e mbledhshme (llogaritur), ndërsa totali i TVSH-së në blerje quhet kreditimi (rimbursimi) i tatimit ose ndryshe TVSH e zbritshme. Diferenca mes TVSH-së së mbledhshme dhe TVSH-së së zbritshme përbënë TVSH-në e pagueshme ose TVSH për t'u marrë (për t'u rimbursuar) në rastet kur TVSH e zbritshme është më e madhe se TVSH e mbledhshme.

3. Aplikimi i TVSH-së në Kosovë

Sipas përkufizimit në dispozitat e përgjithshme të ligjit për TVSH në Kosovë "Tatimi mbi Vlerën e Shtuar - TVSH, përfshin aplikimin e tatimit të përgjithshëm në konsum për mallra dhe shërbime, që është saktësisht proporcional me çmimin e mallrave dhe shërbimeve. TVSH llogaritet në këtë çmim sipas normës së aplikueshme, ngarkohet në fazat e ndryshme të prodhimit, shpërndarjes dhe ciklit jetësor të tregtisë së mallrave dhe shërbimeve, dhe në fund i ngarkohet konsumatorit".

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar në Kosovë ka filluar së aplikuari nga data 01.07.2001, kur norma tatimore ka qënë 15%. Politikat e mirëfillta fiskale tatimore në Kosovë ka filluar kur institucionet qeverisëse të udhëhequra nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë zëvendësohen me institucionet vendore me çrast rregulloret filluan të zëvendësohen me Ligje. Sistemi tatimor i Kosovës ka evoluar nga sistemi i rregulloreve të Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, me kalimin në sistemin e Ligjeve të nxjerra nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, të cilat plotësojnë standardet ndërkombëtare dhe parimet e Bashkimit Evropian. Me 01.01.2009 zëvendësohet rregullorja mbi TVSH-në me Ligj dhe norma tatimore mbi Tatimin e Vlerës së Shtuar ngritet në 16% për të gjitha mallrat dhe shërbimet.

Në gusht të vitit 2015 Kuvendi i Republikës së Kosovës bënë ndryshime në Ligjin e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, duke aplikuar dy norma tatimore, 18% si normë standarde dhe 8% si normë e reduktuar, duke filluar së aplikuari nga shtatori i vitit 2015. Arsye e aplikimit të normës së reduktuar është që të bëhet më e lirë shporta e konsumatorve me mallra dhe shërbime të domosdoshme për jetën e qytetarit.

Nëse i krahasojmë normat tatimore mbi Tatimin e Vlerës së Shtuar të vendeve të rajonit shohim se Kosova bënë pjesë në vendet që kanë norma më të ulta. Kjo vërehet nga tabela e pasqyruar si më poshtë .

Vendi	Norma e TVSH-së
Maqedonia e Veriut	5%, 18%
Shqipëria	6%, 20%
Bullgaria	9%, 20%
Mali i Zi	7%, 21%
Kroacia	5%, 13%, 25%
Greqia	6%, 13%, 24%
Bosnja dhe Hercegovina	17%

Serbia	10%, 20%
Rumania	5%, 9%, 19%
Kosova	8%, 18%

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelë, të gjitha vendet e tjera të Ballkanit, përveç Bosnjë-Hercegovinës aplikojnë norma të reduktuara të TVSH-së, kryesisht për konsumin jetik si shëndetësi, furnizimin e popullatës me energji, transport urban, si dhe për edukimin, librat, revistat dhe veprimtari kulturore apo sportive. Nga shikimi i ndryshimeve ligjore për TVSH-në, për secilin vend ballkanik, vërehet se Kroacia, Greqia prej Janarit 2018 edhe Mali i Zi tani, zbatojnë norma tatimore standarde mbi mesataren e rajonit. Mali i Zi dhe Serbia miratuan në 2016 normë të reduktuar të TVSH-së, respektivisht 7 për qind dhe 10 për qind. Ndërkohë, Mali i Zi prej Janarit 2018 ka rritur normën standarde me 2 për qind më shumë nga sa e kishte më parë. Greqia miratoi në vitin 2016 rritje të normës standarde të TVSH-së me një për qind, duke u renditur si vendi i dytë me normën standarde të TVSH-së më të lartë në Ballkan, pas Kroacisë. Shqipëria, Bullgaria dhe Serbia zbatojnë prej disa vitesh një normë standarde mesatare të TVSH-së në nivelin 20 për qind.⁵⁰

Tabela e rritjes/uljes në përqindje e TVSH-së sipas periudhave tatimore.⁵¹

Nr. rendor	Viti fiskal	Të hyrat nga TVSH sipas viteve	Rritja/ulja në % e TVSH-së sipas viteve	Ndryshimi në rritje/ulje për vit
1	2001 (1/2)	18,218,988.15	0 %	0
2	2002	34,651,397.00	90.19 %	16,432,408.85
3	2003	40,241,617.00	16.13 %	5,590,220.20

⁵⁰ Tatimet në shtetet e rajonit, www.koha.mk

⁵¹ Burimi i të dhënave –Administrata Tatimore e Kosovës.

4	2004	46,259,105.54	14.95 %	6,017,488.34
5	2005	47,301,300.16	2.25 %	1,042,194.62
6	2006	49,960,920.56	5.62 %	2,659,620.40
7	2007	55,602,933.40	11.29 %	5,642,012.68
8	2008	63,933,637.08	14.98 %	8,330,703.68
9	2009	77,868,054.03	21.80 %	13,934,416.95
10	2010	90,584,208.00	16.33 %	12,716,153.97
11	2011	122,253,606.00	34.95 %	31,659,398.00
12	2012	130,495,560.00	6.75 %	8,251,954.00
13	2013	146,726,356.00	12.44 %	16,230,796.00
14	2014	136,939,023.00	-6.67 %	(9,787,333.00)
15	2015	154,947,463.00	13.15 %	18,008,440.00
16	2016	180,363,401.00	16.40 %	25,415,938.00
17	2017	197,699,406.00	9.61 %	17,336,005.00
18	2018	215,184,335.00	8.84 %	17,484,929.00

Nga tabela vërehet se që nga viti 2001 kur ka filluar aplikimi i tatimit mbi vlerën e shtuar me përjashtim të viti 2014, në të gjitha vitet kemi rritje të pagesës së TVSH-së. Nga tabela e mesiperme vërehet se pjesëmarrja e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar në të hyrat e mbledhura nga tatimet është 47%. Standardi European është nga 45% deri 55% pjesëmarrja e TVSh-se në të ardhurat total fiskale.

4. Konkluzion

Në këtë punim shkencor, si hipotezë për testim kemi marrë raportin në mes të nivelit të të hyrave nga TVSH dhe nivelit të GDP-së (Bruto produkti i brendshëm), me qëllim që të vlerësojmë nëse ka një korrelacion pozitiv në mes të dy variablave, e që do të tregojë se një rritje e GDP-së a është e lidhur edhe me rritjen e të hyrave nga TVSH. Të

dhënat për testimin e kësaj hipoteze janë të dhëna sekondare, dhe janë marrë për periudhën 2001-2018.

Pra, H1 = Rritja e të hyrave nga TVSH do të ketë impakt pozitiv në nivelin e GDP-së.

Testimi i hipotezës së ngritur:

Correlations

	TVSH	GDP
Pearson	1	.896**
Correlation		
TVS		
H Sig. (1-tailed)		.000
N	17	17
Pearson	.896**	1
Correlation		
GDP		
Sig. (1-tailed)	.000	
N	17	17

Interpretimi i rezultateve të arritura përmes analizës statistikore: Në bazë të tabelës së mësipërme, të punuar përmes programit softwerik SPSS, mund të konkludojmë se të dhënat nga mostra ofrojnë evidencë të mjaftueshme se rritja e të hyrave nga tatimi mbi vlerën e shtuar ka ndikim pozitiv në nivelin e GDP-së . Ky konkludim vë duke u bazuar në në nivelin e korrelacionit të fituar , ku një korrelacion prej 0.896 në mes të të hyrave nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe nivelit të GDP-së , nënkupton se ekziston një marëdhënie shumë e fortë pozitive në mes tyre, gati pothuajë një marëdhënie perfekte

pozitive. Pra, në bazë të këtij niveli të korrelacionit ne pranojmë hipotezën e ngritur H1, ku vërtetohet edhe në aspektin statistikor se niveli i të hyrave nga TVSH dhe niveli i GDP-së kanë lidhje pozitive, dhe sipas së cilën, rritja e të hyrave nga TVSH ka impakt në rritjen ekonomike të vendit.⁵²

⁵² Dr.Basri Sadriu. Historiku i sistemit tatimor të Kosovës, nocioni, llojet e tatimeve, roli i tyre në buxhetin e Kosovës për periudhën 2000-2018.

IMAZHI NDËRKOMBËTAR I GREQISË DHE MAQEDONISË TË VERIUT PARA MARRËVESHJES TË PRESPËS DHE MARRËDHËNIET BILATERALE MES TYRE

Dr. Sc. Senada LAÇKA

International University of Struga (s.lacka@eust.edu.mk)

Abstrakt

Në shoqëritë e hapura, në vendet e integruara dhe përgjithësisht në kohën e globalizimit, ndërtimi i imazhit, për mirë ose për keq, diktohet nga shumë aktorë. Imazhi ndërkombëtar është tërësia e perceptimeve, opinioneve, ideve, konsiderimeve, emocioneve, ndjenjave që ekzistojnë në faktorë të ndryshëm ndërkombëtar, politikë, diplomatikë, mediatikë, opinionalë, informatikë, individualë, komunitarë për një identitet kombëtar të caktuar (ose një rajon të caktuar).

Kontesti greko-maqedonas e vërteton rëndësinë që ka imazhi ndërkombëtar në bashkësinë ndërkombëtare si dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen shtetet e vogla që duhet mbështetur kryesisht në ndihmën e shteteve dhe institucioneve të tjera, duke e pasur të vështirë të garantojnë pavarësinë e plotë në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Duke analizuar ngjarjet kronologjike, vërehet një periudhë uljeje dhe ngritjeje në marrëdhënjet bilaterale mes dy shteteve duke vërtetuar rëndësinë politike, juridike, ekonomike dhe ndërkombëtare që ka Marrëveshja e Prespës në përmirësimin e marrëdhënjeve të vështira mes dy vendeve.

Fjalë kyçe: *Imazhi ndërkombëtar, Greqia, Maqedonia, ngjarje kronologjike.*

1. Hyrje

Maqedonia dhe Greqia konsiderohen shtete të vogla nëse mbështetemi në definicionin se *“shtete të vogla janë ato me popullatë deri në 15 milion banorë, në të cilën forcat dominante që përcaktojnë politikën dhe sjelljen brenda dhe jashtë shtetit janë të lidhura me identitetin, nevojat dhe qëllimet etnike.”*⁵³

Imazhi ndërkombëtar është mënyra e ekzistencës të identitetit kombëtar në arenën ndërkombëtare. Imazhi si një figure subjektive ndërkombëtare, për identitete të caktuara kombëtare ose rajonale lëviz shumë ngadalë. Ndodh që imazhi të jetë i ngurtësuar dhe nevojitet ndërhyrje, shumë investim, profesionalizëm, struktura dhe mbështetje ndërkombëtare. Për shtete të vogla dhe të varfëra, krijimi i një imazhi ndërkombëtar të mirëfilltë është një proces i vështirë dhe i kushtueshëm. Imazhi mund të shpërftyrohet në një epokë të caktuar por përcillet padrejtësisht univerzalisht dhe jashtë asaj epoke duke mos pasur kufij kohorë, epokalë. Imazhi ka më shumë stereotipe të trashëguara sesa dinamike jetësore. Stereotipet janë pjesë më paradoksale e imazhit dhe janë nga dukuritë më të vështira për tu ndryshuar në imazhin ndërkombëtar të kombeve.

Ajo që paraqet dallimin thelbësor mes dy shteteve fqinje është pozita në avantazh e Greqisë në raportin që gëzon historikisht me shtetet e tjera dhe antarësimi i hërshëm i Greqisë në organizatat ndërkombëtare si NATO, e antarësuar që në vitin 1952⁵⁴ dhe antarësimi i saj në Bashkimin Evropian që në vitin 1981.⁵⁵ Nga ana tjetër, Maqedonia, si rezultat i pengesave ndërkombëtare por dhe vështirësive në politikën e brendshme, gjatë gjithë procesin negociues ka pasur një pozitë dukshëm më pak të favorshme se pala greke sepse, në një periudhë tranzicioni, pozita e pabarabartë e saj gjatë negociatave, nuk i dha

⁵³Efraim Ibar, Gabriel Sheffer, *“Security of Small States in a changing world”*, Routledge, New York, 2013, fq.10.

⁵⁴Resolution on the accession of Greece and Turkey to the North Atlantic Treaty, Approved by the council at the meeting at 2.15 p.m. on 20th September, 1951 (c7-R/11, Item 1), <https://www.nato.int/docu/review/2012/Turkey-Greece/Greece-Turkey-membership/AL/index.htm>

⁵⁵https://europa.eu/european-union/about-eu/countries/member-countries/greece_en

mundësinë për të qënë pjesë e organizatave ndërkombëtare duke e lënë Maqedoninë në një situatë *status quo*.

Maqedonia dhe Greqia, edhe pas marrëveshjes të përkohshme, duket se, e kishin të vështirë që t'i gjenin një urë lidhëse bashkëpunimi duke ndërmarrë veprime dhe qëndrime që i largonin edhe më shumë nga njëra-tjetra dhe kjo vihej re dhe në qarqet politike të të dyja vendeve. Sikur puna të mbetej vetëm brenda kuadrit të marrëdhënieve dypalëshe, do të ishte gjysma e së keqes, por gjendja e tensionuar e këtyre marrëdhënieve reflektohej negativisht në imazhin ndërkombëtar të dy shteteve fqinje, me theks të veçantë në aspiratat euroatlantike të Maqedonisë që konsiderohej objektivi primar i çdo qeverie maqedonase që nga pavarësimi i saj.

2. Vështrim mbi marrëdhënjet greko-maqedonase deri në Samitin e Bukureshtit(2008)

Në vazhdim do të radhiten disa momente të rëndësishme në marrëdhëniet bilaterale mes dy vendeve që vërtetojnë një raport të tensionuar dhe me qëndrime pa kompromis nga të dy palët në një vështrim më shume se njëzet vjeçar të marrëdhënieve diplomatike mes dy vendeve fqinje.

Në nëntor të vitit 2004, SHBA-ja pranoi Maqedoninë me emrin e saj kushtetues. Washingtoni zyrtar e pranon Republikën e Maqedonisë me emrin kushtetues pas fitores të Presidentit amerikan Xhorxh Bush. Nga ana tjetër, Komisioni Evropian në Raportin lidhur me statusin e shtetit kandidat për Maqedoninë të muajit nëntor 2005, konkludon, në mes tjerash, se...*"kontesti me emrin mbetet i hapur dhe se përpjekjet për zgjidhjen e të njëjtit duhet të përforcohen në një periudhë konstruktive për të qënë e mundur sa më shpejtë të gjindet në zgjidhje e pranuar në kuadër të rezolutave të Kombeve të Bashkuara dhe në interes bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore..."*⁵⁶ Zëdhënësi i Ministrisë të punëve të jashtme të shtetit grek në atë kohë, Jorgos Kumucakos, duke u thirrur në këtë

⁵⁶ Ky raport u miratua saktësisht në 9 nëntor të vitit 2005, me emërtimin në gjuhën frënge AVIS, me gjithsej 143 faqe, dispozita e cituar është në faqe 33 në pjesën që diskutohen marrëdhëniet me fqinjët.

pjesë të raportit, deklaroi se... *“Kjo paraqet një sukses të veçantë për diplomacinë greke sepse për herë të parë në një dokument zyrtar të Bashkimit Evropian është përfshirë kërkesa greke për çështjen e emrit. Ky sukses është rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme dhe sistematike-të qeta por efektive...”* Si plotësim i kësaj deklarate, në Deklaratën e Ministrisë greke për punë të jashtme shtohet se *“në mendimin e shprehur nga Komisioni është e qartë se integrimi i shtetit tonë fqinj në BE vazhdon nën emrim FYROM. Shteti fqinj do të duhet të bashkëpunojë për të gjetur një zgjidhje të pranueshme për të dy palët rreth çështjes të emrit, me çka, kjo çështje, tani dhe formalisht shëndrohet në kriter politik për antarësim. Ky ka qënë gjithmonë pozicioni grek... Ne mbetëm të qëndrueshëm në pozicionet tona, njëkohësisht duke vërtetuar konstruktivitetin tonë...”* thuhet në deklaratë.⁵⁷

Moment tjetër i rëndësishëm i marrëdhënieve mes Maqedonisë dhe Greqisë rreth çështjes të emrit është i ashtuquajtur *“Memorandum i Intelektuarëve Grekë”* për hedhjen poshtë të emrit FYROM në 9 mars të vitit 2006. Në petitionin e nënshkruar, të publikuar në revistën ditore të Athinës *“ELEFTHEROTYPIA”*, 56 (pesëdhjetë e gjashtë) intelektualë të majtë, progresivë grekë, deklaruan se ato kishin vendosur që shteti fqinj në veri të Greqisë, Republikën e Maqedonisë ta emërtojnë sipas emrit të saj kushtetues, duke mos marrë parasysh qëndrimin e Athinës zyrtare! Ato publikisht deklaruan se... *“do të shkëputemi nga maja e shtetit dhe do ta quajmë Republika e Maqedonisë, me emrin e saj kushtetues, gjegjësisht, me emrin e saj të vetëm, legjitim dhe të vërtetë.”* Në tekstin e firmosur nga ana e tyre, theksojnë se Republika e Maqedonisë është pranuar nga dhjetëra shtete nga e gjithë bota, përveç nga nacionalistët grekë dhe se në kongrese, libra shkencore në të gjithë botën përdoret termi *“Republika e Maqedonisë”*. Ato konsiderojnë që do të ishte njerëzore dhe e mundur që kjo situatë të ndryshonte. Duhet pasur parasysh fakti se ky petition është nënshkruar nga personalitete të suksesshme të botës greke dhe përveç një pjese që vijnë nga qytetet e ndryshme të Greqisë, pjesa tjetër jetojnë, veprojnë dhe punojnë në shtetet e ndryshme të Evropës me profile dhe profesione të ndryshme.

⁵⁷Дневник, бр. 2 909; 11 ноември 2005; стр. 2.

Që në vitin 2000, gjatë kampanjës presidenciale në SHBA, Presidenti Bush ka theksuar se: „*Të gjitha demokracitë e reja të Evropës deri në Detin e Zi duhet të kenë mundësi të barabarta për siguri dhe liri dhe mundësi të njëjta që ti bashkangjiten insitucioneve të Evropës*”⁵⁸. Vetë fakti që Samiti i Alenacës do të mbahej në Rajon, jepte një mesazh pozitiv për tre shtetet aspirante për antarësim-R.Maqedonisë, Republika e Shqipërisë dhe R.Kroacisë si shtete të A3 që iu referuan Deklaratës në Samitin në Riga, në vitin 2006, në të cilën neni 29 thekson se “*vërtetohet përgjegjësia e NATO-s për anëtarët e ri evropian*”.⁵⁹

Një përplasje serioze mes dy shteteve fqinje që lidhet drejtpërdrejtë me emrin, ndodhi në fillim të vitit 2008. Pavarësisht nga fakti se Sekretariati i NATO-s dhe Këshilli Veriatlantik katër muaj para fillimit të Samitit ende nuk e kishin futur në rend të ditës çështjen e zgjerimit, në disa institucione të rëndësishme dhe të afërta me Aleancën, hapur diskutohej mbi zgjerimin e ardhshëm për aspirantët e Kartës të Adriatikut(A3).

Në periudhën 2005-2008, Republika e Maqedonisë e kishte humbur pozicionin e të qenit lider sipas reformave në mes tre shteteve aspirante. Gjatë vizitës në Shkup, në mars të vitit 2006, ambasadori amerikan në NATO, Viktorija Nuland ka diktuar më shumë obligime për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë. Në këtë aspekt, i jepet një rëndësi e veçantë disa pikave si:

1. Zgjedhjet e lira dhe demokratike dhe konstituimi i Qeverisë deri në verën e të njëjtit vit dhe nga vjeshta të fillohej me reformat e nevojshme;
2. Transformimet gjyqësore dhe ligjore;
3. Ligji për policinë;
4. Lufta kundër korrupsionit dhe Krimit të organizuar;
5. Arritje pozitive në sferën ekonomike;
6. Bashkëpunimi rajonal;
7. Forcimi i Qendrës për menaxhimin e krizave;

⁵⁸Д-р Нано Ружин, “НАТО во современите меѓународни односи”, “Фридрих Еберт”, Скопје 2010, стр.300.

⁵⁹Declaration du Sommet de Riga - Communique de Press 2006 - 150/29.11.2006

8. Zbatimi i planit nacional për menaxhimin e integruar kufitar;
9. Reforma në kundërzbulim në aspekt të kordinimit dhe integritetit të shërbimeve;
10. Transformime mbrojtëse dhe pjesëmarrje në misione paqësore.

Në kuadër të diplomacisë multilaterale të Aleancës, Republika e Maqedonisë, si një shtet i vogël, i varfër dhe jo mjaftueshëm i afirmuar, në NATO ka luftuar për të lënë një përshtypje shumë të theksuar. Kjo u arrit si rezultat i simpatie të mëdha gjatë krizës kosovare, rolin e Republikës së Maqedonisë si pjesë e KFOR-it, por edhe për origjinalitetin e modelit të tij multietnik, i krijuar në periudhën e krizës të vitit 2001, që përfundoi me nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Republika e Maqedonisë, në kohën e krizës të vitit 2001, evuloi në një eksportues të sigurisë nëpërmjet dërgimit të misioneve paqësore në Afganistan dhe Irak.

Në takimin e fundit të Këshillit Veriatlantik të Aleancës, në format të ministrave për punë të jashtme, i mbajtur në Bruksel në muajin dhjetor, të gjithë ministrat në diskutimet e tyre janë dakorduar se Samiti i Bukureshtit duhet të jetë një Samit për Zgjerim.

Konkretisht, principi i marrëdhënjëve të fqinjësisë të mirë si një ndër principet bazike të Kartës të Kombeve të Bashkuara ka qënë arsyeimi i diplomacisë greke që të pengojë ftesën e Republikës të Maqedonisë në Samitin e Bukureshtit, 2008.

Greqia, në fakt, opstrukcionin e tillë mund kishte kryer edhe më vonë nëpërmjet mundësive inastitucionale, edhe në qoftë se do ishte dërguar ftesë për antarësim të Republikës së Maqedonisë. Në fakt, Protokolli për antarësim i çdo shteti kandidat është e nevojshme të kalojë procesin e ratifikimit në çdo shtet anëtar. Në atë periudhë, ekzistojnë së paku pesë mundësi procedurale për bllokimin e shtetit aspirant, duke filluar nga pushteti ekzekutiv dhe duke mbaruar me parlamentin, si dhe në kuadër të komiteteve punuese të Këshillit Veriatlantik.

Megjithatë, diplomacia greke kishte vendosur që bllokimin në Samitin e Bukureshtit ta bënte së paku për tre arsye:

1. Së pari, të tregojë se sa i thellë dhe i ndjeshëm ka qënë problemi me Republikën e Maqedonisë dhe atë në praninë e numrit më të madh të burrshtetasve dhe medimeve;
2. E dyta, të imponojë problemin si fenomen multilateral të marrëdhënjëve problematike të miqësisë të mirë, me faktin që pas bllokimit të Republikës së Maqedonisë në Bukuresht 2008, në asnjë dokument nuk figuron Greqia, por si nënshkruese paraqitet NATO, edhe pse të gjithë e kishin të qartë se kjo pengesë diplomatike ka qënë rezultat i diplomacisë greke;
3. E treta, të tregojë fuqinë e Greqisë dhe të paralajmërojë udhëheqësinë maqedonase se në të ardhmen, në qoftë se nuk gjendet një zgjidhje kompromisi për problemin, bllokimet diplomatike të Greqisë do të vazhdojnë dhe në aspektin e integriteteve të Republikës së Maqedonisë në BE.

Samiti i NATO-s në Bukuresht, në 2-4 Prill të vitit 2008, është realizuar në periudhë jashtëzakonisht dinamike për marrëdhëniet ndërkombëtare, që ishin të ndërlidhura me: Pranimin e pavarësisë së Kosovës, Mbrojtja antiraketë e SHBA-ve në territorin e Polandës dhe Çekisë, që ka shqetësuar dukshëm diplomacinë evropiane dhe ruse, pasiguria e eksportimit të gazit rus drejtë Ukrainës dhe Evropës, kriza ruso-britanike për përzënjen e diplomatëve, mbështetja e Senatit Amerikan dhe administrata e presidentit Bush për zgjerimin e ri të Aleancës nëpërmjet dhënjes të statusit për shtet kandidat të Ukrainës dhe Gruzisë⁶⁰.

Samiti i Bukureshtit ishte Samiti i fundit i Bushit dhe Putinit dhe i pari i Sarkozisë. Për këtë arsye, sipas Lamfausit, „Askush nuk ka dashur t’ju prishë kënaqësinë në Samitin e fundit të tyre”⁶¹. Megjithatë, Greqia kërcënonte fuqishëm, duke përkrahur Shqipërinë dhe Kroacinë por jo edhe Maqedoninë. Ministri i Punëve të Jashtme të Greqisë, ka theksuar se „Greqia e përkrah kandidaturën e Kroacisë dhe Shqipërisë, kurse lidhur me Republikën e Maqedonisë, për shkak të pozicionit të tyre nacionalist, nuk kemi qëndrim të njëjtë rreth

⁶⁰Д-р Нано Ружин, „НАТО во современите меѓународни односи”, „Фридрих Еберт”, Скопје 2010,ст. 309

⁶¹Д-р Нано Ружин, „НАТО во современите меѓународни односи”, , ст.311

kandidaturës së saj “. Administrata amerikane, në krye me Presidentin Bush paraqet një argument të fuqishëm në favor të Republikës së Maqedonisë, por, ashtu si që është shprehur gazetari i *„Le Figaro”*,⁶² *„Athina ka arritur ti paraqesë më mirë kontraargumentet”*, “Sipas tyre, Maqedonia nuk ka qënë e gatshme për kompromis, edhe pse Javier Solana ka propozuar formulën *“Maqedonia e Re.”*”⁶³

Dy ditë para fillimit të Samitit, Ish Sekretari Shtetëror për Mbrojtje të SHBA-ve, Donald Rumsfeld, ka inkurajuar tre aspirantët e Kartës të Adriatikut: *„Këto tre shtete, në vitet e kaluara janë përgatitur mire për t’ju bashkangjitur Aleancës ndoshta gjeografikisht këto tre shtete nuk janë të mëdha, por në aspektin operativ kanë dhënë kontribut në Afganistan dhe Irak, kanë treguar aftësitë e tyre më shumë sesa madhësia e tyre, për dallim prej disa shteteve më të mëdha që mbetën jashtë, osë jomjaftueshëm janë angazhuar....”*.⁶⁴

Përkundër pritshmërive optimiste për zgjerimin, dita e parë në Samitin e Bukureshtit të 26 shefave të shteteve ose qeverive ka përfunduar me dështim për tre nga pesë kandidatët.⁶⁵

Dy shtetet që përfituan dhe dolën nga statusi i përcaktuar me Kartën e Adriatikut në favor të antarësimit të barabartë me shtetet e tjera anëtare, ishin Shqipëria dhe Kroacia. Tirana dhe Zagrebi një javë më vonë kishin mundësinë të fillojnë negociatat për antarësim.

Dështimi në Bukuresht paraqiste një sinjal të rrezikshëm për stabilitetin rajonal sipas Ministrit të Punëve të Jashtme të Danimarkës, Uffe Ellemann-Jensen.⁶⁶

Qëndrime të ngjajshme ka pasur edhe drejtori i Projekteve të reja demokratike nga Qendra për Studime Ndërkombëtare dhe Strategjike në Washington, Janusz Bugajski, i cili në *„The Wall Street Journal”* ka deklaruar se: *Në mungesë të antarësimit në Alenacë, Republika e Maqedonisë po shëndrohet në një shtet të përkohshëm. Rusia, me siguri do të*

⁶²Thierry Portes (19.03.2008r.)

⁶³The Wall Street Journal –“NATO Expansion Should Continue”, 28 mars, 2008.

⁶⁴The Wall Street Journal –“NATO Expansion Should Continue”, 28 mars 2008.

⁶⁵ Christoph Lamfalussy, *„Deux sur cinq dans l’OTAN”*, Libre Belgique, 04.04.2008.

⁶⁶ The Japan Times, “NATO meeting sends dangerous signals”-9 prill 2008.

mundohet të përfitojë nga bashkëpunimi i përforcuar politik, ekonomik dhe të sigurisë me Shkupin, duke u munduar të imponohet si mbrojtëse e Republikës së Maqedonisë nga panalbanizmi në rajon dhe terrorizmi islamik...”⁶⁷

3 Pasojat juridike dhe politike për Maqedoninë pas Samitit të NATO-s

Në vazhdim, do të bëhet një përmbledhje e ngjarjeve kryesore që lidhen drejtpërdrejtë me një ndër eventet më të rëndësishme politike të vitit 2008- Samiti i NATO-s para dhe pas Samitit:

1. Në darkën solemne të shëfave të shteteve dhe qeverive, nga ana e kryeministrit grek Kostas Karamanlis, i cili më herët kishte pasur një diskutim të ashpër me presidentin amerikan Xhorxh Bush, kishte dhënë propozim për emrin *“Republika e Shkupit (Maqedoni)”* por ishte refuzuar nga delegacioni maqedonas si i papërshtatshëm.
2. Greqia e përdori të drejtën e paralajmëruar të *“vetos”* dhe me këtë veprim pengoi pranimin e Maqedonisë në NATO duke bërë një shkëputje të Maqedonisë nga grupi i Adriatikut (Kroacia+Shqipëria+Maqedonia). Ky veprim ishte bërë që në 2 prill të vitit 2008 kurse zyrtarisht ishte vërtetuar nga ana e Sekretarit Gjeneral të NATO-s.
3. Që në Pres konferencë, gazetarët maqedonas në shenjë proteste, kishin lëshuar sallën. Më vonë, të njëjtën ditë, këtë veprim e bëri dhe delegacioni i shtetit maqedonas.⁶⁸ Në 8 prill të vitit 2008, ishte sulmuar shtëpia e priftit Nikodim Carknjas, maqedonas etnik nga Maqedonia e Egjeut që ishte larguar nga detyra në kishën greke sepse po mbante liturgji në gjuhën maqedonase;
4. Pas euforisë fillestare në Greqi, filluan të zhvilloheshin një sër ngjarjesh të padëshirueshme të të ashtuquajturës *“luftë e qetë tregtare”* mes dy shteteve: Në 7 prill 2008, një grup i armatosur grek ultra-nacionalist publikoi inçizime të

⁶⁷ Janusz Bugajski - „Balkan Fix“- The Wall street journal, 10.04.2008.

⁶⁸Në këtë delegacion të përbërë prej afërsisht 50 delegatëve, nuk kishte asnjë përfaqësues të opozitës.

personave të armatosur që i drejtoheshin popullit maqedonas me kanosje dhe ofendime; Në 9 prill 2008, Presidenti i organizatës të Maqedonasve në Greqi „Виножито”⁶⁹ – pionir i të drejtave dhe lirive të njeriut për maqedonasit që jetojnë në Greqi, z. Pavle Filipov Voskopulos ka pësuar sulm në tru por disa media greke të majta kanë publikuar lajmin se ka pasur dyshime për helmimin e tij nga shërbimet sekrete greke në vendit e tij të punës; Në 13 prill 2008, një grup i pidentifikuar vendosën flamurin grek në kishën maqedonase të Lerinit. Në 14 prill 2008, në një konferencë ndërkombëtare të mbajtur në Athinë nga ana e *Diplomacy Magazine*, ministrja e atëhershme greke për punë të jashtme, znj.Dora Bakoyannis, dekalroi se...” *Greçia do të përdor të drejtën e vetos edhe gjatë përcaktimit të datës për fillimin e negociatave të vendit fqinj për antarësim në BE*”.⁷⁰ Në 17 prill të vitit 2008, Autoriteti grek i Aviacionit Civil i bëri ndalesë kompanisë maqedonase MAT çdo lloj fluturimi mbi territorin grek, me çka kompania i anuloi fluturimet e planifikuara qarter drejt ishujve grekë. Në 3 Maj 2008, autoritetet greke ndaluan të gjitha transaksionet bankare drejtë Republikës së Maqedonisë, të cilat realizoheshin nëpërmjet ekspoziturave të Western Union; Në 10 Maj 2008, transportuesit maqedonas ishin të malltretuar në territorin grek nga një grup njerëzish (50-60 shtetas grek), të cilët përveç keqtrajtimit, i kanë detyruar të largojnë ngjitëset me shenjën MK nga mjetet e tyre të transportit. Edhe pse policia greke ka qënë në vendin e ngjarjes, sipas dëshmimeve, nuk ka intervenuar.

Humbësi më i madh në Samitin e Bukureshtit pa dyshim ka qënë Republika e Maqedonisë dhe kishte rrezik që të ballafaqohej me një stuhi të fuqishme të Natoskepticizmit. Dështimi i Bukureshtit paraqiste një frustrim politik shumë të thellë si për elitën politike ashtu edhe për qytetarët e Maqedonisë dhe hapi një morri procesesh të reja në politikën e brendshme dhe të jashtme të Republikës së Maqedonisë.

⁶⁹ Në përkthim -Ylberi⁷⁰ ТВ А1 и ТВ Канал 5; Информативна програма Дневник; 14. IV. 2008

4. Padia e qeverisë maqedonase para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë

Në planin e brendshëm, qeveria ka zhvilluar një kampanjë për rrënjët antikë të maqedonasve nëpërmejet financimit të spoteve të shtrenjta publicitare të rregjisorëve të afirmuar, duke intensifikuar kërkimet arkeologjike në të gjithë territorin e shtetit, me qëllim që të gjenden artifakte të reja nga e kaluara antike.

Në planin e jashtëm, Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka vendosur që në datë 02.12.2008 të padisë Greqinë para Gjykatës ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë. Me këtë veprim, kontesti me emrin kaloi nga një problem diplomatik në një problem juridik.

Maqedonia dërgoi kërkesë në Regjistrin e Gjykatës me qëllim që t'i kërkohej Greqisë t'i respektojë obligimet e veta ligjore të parapara me Marrëveshjen e përkohshme, e cila është juridikisht obliguese për të dy vendet. Gjykata në Hagë solli aktvendim se Greqia ka shkelur nenin 11 të Marrëveshjes së përkohshme duke bllokuar anëtarësimin e Maqedonisë në NATO në Samitin e Bukureshtit në vitin 2008.

Sipas Gjykatës në Hagë:

- Duke kundërshtuar në antarësimin e Maqedonisë në NATO në periudhën e Samitit të Natos në Bukuresht 2008, Greqia ka shkelur Marrëveshjen e Përkohshme të vitit 1995;
- Nga Greqia pritet që nuk do të shkelë përsëri të drejtën ndërkombëtare (sipas definimit parashikohet parimi i mirëbesimit);
- Maqedonia edhe më tej mund ta përdorë emrin e saj kushtetutes në marrëdhëniet me Greqinë në kuadër të organizatave ndërkombëtare;
- Të gjitha pretendimet e Greqisë se Republika e Maqedonisë e ka shkelur Marrëveshjen e Përkohshme janë hedhur poshtë.

Vendimi i Gjykatës në datë 5 dhjetor 2011 është i detyrueshëm për palët dhe kundër tij nuk lejohet përdorimi i mjeteve juridike.

Në bazë të argumenteve dhe pretendimeve të cilat i parashtroi Maqedonia, Gjykata vendosi që e vetmja çështje që është jashtë kompetencave të saj është sjellja e vendimit për ndryshimet rreth emrit të Republikës të Maqedonisë. Padia e ngritur nga Republika e Maqedonisë ka të bëjë vetëm me veprimet nga ana e Greqisë, që në fakt janë pjesë e juridiksionit të Gjykatës. Fakti që negociatat po zhvillohen njëkohësisht me sjelljen e vendimit, nuk janë pengesë juridike që Gjykata të zbatojë funksionet e saj gjyqësore. Edhe pse paragrafi 1 i nenit 11 të Marrëveshjes të Përkohshme lejon kundërtshtim nëse Republikës të Maqedonisë në NATO i drejtohen si "*Republika e Maqedonisë*", në fakt, Maqedonisë do i drejtoheshin me emrin e saj kushtetues por për çdo rast, duhet theksuar se kjo nuk ishte arsyja e kundërshtimit të Greqisë. Greqia nuk ka mundur të vërtetojë se cila do dispozitë nga Pakti NATO lejon që Greqia të kundërshtojë antarësimin e Maqedonisë. Pasi Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e Greqisë për veprime të paligjme nga ana e Maqedonisë, Gjykata ka vërtetuar se nuk ka një veprim të paligjshëm, përveç në një rast të vitit 2004 ku bëhet fjalë për shkelje jomateriale të Marrëveshjes të Përkohshme. Pas reagimit të Greqisë në vitin 2004 lidhur me këtë çështje, po të njëjtin vit, Maqedonia ka ndaluar së përdoruri simbolin në fjalë. Gjykata në mënyrë eksplicite vendosi se Maqedonia ka të drejtë të emërojë vetëveten si Republika e Maqedonisë në marrëdhëniet e saj me Greqinë dhe se Greqia nuk ka të drejtë të kundërshtojë antarësimin e plotë të Maqedonisë në NATO ose organizata të tjera sepse Maqedonia ka pretenduar të përdor emrin e saj kushtetutes gjatë antarësimit të saj në organizatat ndërkombëtare.⁷¹

Edhe pse vendimi i Gjykatës drejtpërdrejtë nuk ka të bëjë me shtetet e treta ose me vetë NATO-n dhe BE-në, Gjykata vërtetoi se kundërshtimi nga ana e Greqisë para dhe gjatë kohës të Samitit në Bukuresht paraqet shkelje të së drejtën ndërkombëtare. Siç është pranuar gjërësisht se kundërtshtimi i Greqisë në fakt është dhe arsyeja kryesore që ka bllokuar arritjen e konsensusit për çështjen në fjalë, si rezultat i kësaj, Maqedonia nuk morri ftesë për antarësim në NATO. Nëse do ishte marrë parasysh vendimi dhe ishte hedhur poshtë vendimi në Bukuresht, do të përmirësoheshin sado pak pasojat dhe do

⁷¹Пресуда на Меѓународниот Суд на Правдата од 5 декември 2011 година, Параграф 103

respektohej Marrëveshja e Përkohshme, qëllimi kryesor i së cilës ka qënë normalizimi i marrëdhënjëve greko-maqedonase dhe krijimi i një klime të një sigurie juridike në raportet mes dy shteteve.⁷²

5. Marrëdhënjet greko-maqedonase deri në Marrëveshjen e Prespës

Në janar të vitit 2012, zëvendës-kryeministrja e atëhershme e Maqedonisë për çështje evropiane, znj. Teuta Arifi, realizoi një vizitë dyditore në Greqi. Në Maj të vitit 2013, zëvendës-kryeministri i Maqedonisë, për çështje evropiane, z. Fatmir Besimi gjithashtu realizoi takim dyditor në Greqi. Me qëllim të përparimit të marrëdhënieve mes dy shteteve, në mes Ministrive për Punë të Jashtme ekziston bashkëpunim ekspertësh në sferën e eurointegritimeve. Kështu, në 7 qershor të vitit 2012, në Athinë u mbajtën konsultimet e para në nivel ekspertësh për Bashkimin Evropian duke diskutuar çështjet e ngritura nga ministrinë përkatëse. Në prill të vitit 2013 në Shkup u realizua po i njëjti proces konsultimesh mes ministrive lidhur me BE-në.

Në 20 shkurt të vitit 2014, Kryeministri grek dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Evangelos Venizelos vizitoi Maqedoninë në kuadër të turneut ballkanik për presidencën e Greqisë me Këshillin e Bashkimit Evropian.⁷³

Në Qershor të vitit 2015, dy shtetet arritën dakordim për një sër masash për ndërtim mirëbesimi dhe fillimi të një procesi bashkpunimi për sferat e identifikuese dhe krijimi të një klime për të gjetur eventualisht një zgjidhje të mundshme për tejkalimin e dallimeve rreth emrit.

Deri në zgjidhjen e Kryeministrit të ri maqedonas Zoran Zaev, në Qershor të vitit 2017, Maqedonia ballafaqohet me një izolim ndërkomëhtar indirekt por dhe një stagnim të dukshëm në negociatat dhe dialogun me Greqinë nën mbikqyrjen e OKB-së. Pas

⁷²Клучни Елементи Република Македонија против Грција -Пресуда на Меѓународниот Суд на Правдата од 5 декември 2011 година

⁷³http://mfa.gov.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=244&catid=82&Itemid=349&lang=mk

ardhjes në pushtet të LSDM-së, në krye me kryeministrin Zaev, u premtua arritja e një zgjidhjeje për kontestin me Athinën zyrtare dhe ripërtirja e aspiratave për antarësim në BE dhe NATO.

Në fillim të muajit Shkurt 2018, Zaev deklaroi se Maqedonia do të përfshijë një përcaktim gjeografik në emrin e ardhshëm, me çka, më pas filluan të publikoheshin propozimet e mediatorit Nimetz: Maqedonia e Epërme, Maqedonia e Veriut, Maqedonia e Vardarit dhe Maqedonia (Shkupi). Në vitin 2018, qeveritë e dy shteteve rëndësinë me të madhe në politikën e jashtme e fokusuan në përgatitjen e terrenit për realizimin e takimeve mes liderëve nëpërmjet informimit të vazhdueshëm lidhur me negociatat. Edhe pse në këtë periudhë, u vërejt një pakënaqësi e shprehur tek opozita e dy shteteve që reagonin për informacionin e pamjaftueshmë që kishin lidhur me mbarëvajtjen e negociatave. Çdo ditë e më shumë po përforcohej besimi se palët po i afroheshin zgjidhjes. Në 12 qershor të vitit 2018, u bë zyrtar njoftimi se kryeministrat e Maqedonisë dhe Greqisë, Zoran Zaev dhe Aleksis Cipras pas bisedës të dytë zyrtare telefonike kanë arritur në një zgjidhje të përbashkët për emrin e Maqedonisë që në të emërtohet si Republika e Maqedonisë të Veriut për përdorim gjithëpërfshirës. Sipas asaj që kanë rënë dakord palët, çështjet e tjera të hapura si identiteti dhe gjuha mbetën të paprekura.

Duke u mbështetur në analiza të caktuara, vërtetohet se Maqedonia, deri në fillim të vitit 2017 ka ratifikuar një numër relativisht më të vogël të marrëveshjeve bilaterale në fusha të ndryshme me Greqinë për dallim nga shtetet e tjera fqinje, edhe pse një pjesë e tyre nuk janë më në fuqi. Me Republikën e Shqipërisë, Maqedonia ka ratifikuar gjithsej 37 marrëveshje, njësoj dhe me Republikën e Bullgarisë, 18 marrëveshje bashkëpunimi me Republikën e Kosovës, me Moldavinë 7 marrëveshje, 18 Marrëveshje me Romaninë, 32

Marrëveshje me Slloveninë, 16 marrëveshje me Serbinë, 36 marrëveshje me Turqinë, 31 marrëveshje me Kroacinë dhe 20 marrëveshje me Malin e Zi.⁷⁴

Mes Maqedonisë dhe Greqisë, numri i realizuar i marrëveshjeve dypalëshe të ratifikuara gjatë periudhës kur dy shtetet kishin dallime lidhur me emrin, është vetëm dy marrëveshje prej të cilave, asnjëra nga marrëveshjet nuk është në fuqi aktualisht.

Data e Ratifikimit nga Parlamenti maqedonas	MARRËVESHJA E RATIFIKUAR
12.11.1995	Marrëveshja e përkohshme mes Republikës të Maqedonisë dhe Republikës të Greqisë në New York në 13.10.1995 (Ligji për ratifikim është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës të Maqedonisë nr.48) ⁷⁵
27.09.1999	Marrëveshje Bilaterale mes Republikës të Maqedonisë dhe Republikës të Greqisë për ndërtimin dhe menaxhimin me tubacionet e naftës (Ligji për Ratifikim është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës të Maqedonisë nr.62) ⁷⁶

Tabela 1. Marrëveshjet bilaterale mes Maqedonisë dhe Greqisë para Marrëveshjes të Prespës **Burimi (autori)**

⁷⁴Илија Милчевски, Фани Коровешовска, “Билатералните Односи меѓу Република Македонија и државите од југоисточна Европа - преглед на ратификуваните билатерални договори – студија”, Собрание На Република Македонија-Парламентарен Институт, Скопје, јуни 2017

⁷⁵Marrëveshja e Prespës ka shfuqizuar Marrëveshjen e Përkohshme të vitit 1995

⁷⁶ Kjo marrëveshje u shfuqizua me vendim të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë me nr.140/2001 e datës 4 dhjetor 2002 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë me nr.98, me datë 27.12.2002)

6. Konkluzion

Shtrohet pyetja, a mund të gjendet një zgjidhje juridike për një kontest tipik politik? Sigurisht që është e mundur. Në fakt, aspekti juridik për një kontest politik lidhur me emrin ka qënë një veprim jo i zakonshëm sepse në Komunikatën përfundimtare të Samitit të Bukureshtit, në asnjë pjesë të saj nuk figuron Greqia si autore e vetos maqedonase por Aleanca, gjegjësisht Këshilli Veriatlantik, në format të shfave të shteteve dhe qeverive. Përveç kësaj, edhe pala greke do të paraqesë argumente për shkelje të Marrëveshjes të përkohshme.

Intelektualët, që u afirmuan si të afërt me qeverinë, mbronin tezën se emri është i barabartë me identitetin e maqedonasit. Në qoftë se Maqedonia e humb emrin, do të humbasë edhe identitetin dhe do të zhduket nga harta e botës. Në mes të tjerash, Republika e Maqedonisë edhe të pranojë ndryshimin e emrit, kërkesat e Greqisë do të shkojnë më tej, duke kërkuar ndryshimin e emrit të gjuhës, popullatës dhe të gjitha emrat që kanë të bëjnë me nocionin Maqedoni⁷⁷.

Kjo teori shkoi më së miri në favor të kundërshtarëve brenda NATO-s të cilët duke shfrytëzuar këtë pengesë hasën në arsyetim të mirëfilltë të veprojnë kundër hyrjes së Republikës së Maqedonisë në NATO.

Të gjitha palët që mbështetën kompromisin dhe ndryshimin e emrit u kategorizuan si tradhëtarë të kauzës shtetërore dhe interesit shtetëror ose shprehjen që Kardinali Rishelieu ka përdorur -*Raison d'etat*. Sipas tij, *“interesi primar i çdo shteti është integriteti dhe sovraniteti territorial si dhe mirëqënja e shtetit dhe popullit, ato kanë përparësi para prioriteteve të tjera”*.

Faktet historike vërtetojnë se gjithmonë ka qënë e rëndësishme dhe në interes të dy shteteve që të zhvillojnë marrëdhënie të afërta me njëri tjetrin, të bazuara në respekt të ndërsjelltë. Një zgjidhje e shpejtë dhe e përbashkët për çështjen e emrit do të ishte veprim i shumëpritur nga popullsia e të dy vendeve sepse shtyrja e zgjidhjes për nesër,

⁷⁷Д-р Нано Ружин “НАТО во современите меѓународни односи”, fq. 318

nuk ka qënë një politikë e arsyeshme por është e kuptueshme për politikanët që kanë dashur të shmangin përgjegjësi politike duke u përfshirë në çfarë do kompromisi.

Vizioni strategjik i bashkësisë ndërkombëtare për marrëdhënjet bilaterale mes Maqedonisë dhe Greqisë është një partneritet dhe aleancë mes dy vendeve, duke përcjellur porosinë se Athina duhet të ketë një fqinj të qëndrueshëm dhe të sigurtë në veri të saj kurse Shkupi nga ana tjetër, ka nevojë për një fqinj të fuqishëm që do mbështesë hapat e saj drejtë integritetit dhe perspektivës evropiane.

Literatura

- Д-р Нано Ружин *“НАТО во современите меѓународни односи”*; Фридрих Еберт”, Скопје 2010;
- Илија Милчевски, Фани Коровешовска, *“Билатералните Односи меѓу Република Македонија и државите од југоисточна Европа - преглед на ратификуваните билатерални договори – студија”*, Собрание На Република Македонија-Парламентарен Институт, Скопје, јуни 2017;
- http://mfa.gov.mk/index.php?option=com_content&view=article&catid=244&catid=82&Itemid=349&lang=mk
- Пресуда на Меѓународниот Суд на Правдата од 5 декември 2011 година, Параграф 103;
- Клучни Елементи Република Македонија против Грција -Пресуда на Меѓународниот Суд на Правдата од 5 декември 2011 година;
- ТВ А1 и ТВ Канал 5; Информативна програма Дневник; 14. IV. 2008;
- Bashkurti, Lisen *„Identiteti, Imazhi, Diplomacia”*, Akademia Diplomatike Shqiptare, Tiranë, 2004;
- Efraim Ibnar, Gabriel Sheffer, *“Security of Small States in a changing world”*, Routledge, New York, 2013, fq.10.

- Resolution on the accession of Greece and Turkey to the North Atlantic Treaty, Approved by the council at the meeting at 2.15 p.m. on 20th September, 1951 (с7-R/11, Item;
- <https://www.nato.int/docu/review/2012/Turkey-Greece/Greece-Turkey-membership/AL/index.htm>
- https://europa.eu/european-union/about-eu/countries/member-countries/greece_en;
- Дневник, бр. 2 909; 11 ноември 2005; стр. 2.
- Declaration du Sommet de Riga - Communiqué de Presse 2006 - 150/29.11.2006
- The Wall Street Journal – “NATO Expansion Should Continue”, 28 mars 2008.
- Christoph Lamfalussy, „Deux sur cinq dans l’OTAN”, Libre Belgique, 04.04.2008.
- The Japan Times, “NATO meeting sends dangerous signals” - 9 prill 2008.

KONSULENCA LIGJORE DHE SHËRBIMET E AVOKATISË

Sheremet Hebib LIVOREKA

(sheremet.livoreka@hotmail.com)

Abstrakt

Legal consulting services usually include advising people, businesses and other organizations on any legal obligations or issues. Legal consultants are experts in various areas of law. Some specialize in a particular area of law, such as business, civil, criminal, or juvenile law. Lawyers usually represent and defend their clients in legal proceedings. The lawyer thoroughly researches clients' cases to enable them to find different solutions to the question or problem. A lawyer can also take on the role of legal advisor. A consultant from a law firm helps and advises law firms. Using his expertise in legal and business consulting can help a lot in the growth of the business, because within the business there will be strategies that will help to focus on their work.

Keywords: *Lawyer, client, firm, expertise.*

1. Hyrje

Shërbimet juridike konsulente zakonisht përfshijnë këshillimin e njerëzve, bizneseve dhe organizatave të tjera për çdo detyrim apo çështje ligjore. Konsulentët ligjorë janë ekspertë në fusha të ndryshme të ligjit. Disa janë të specializuar në një fushë të veçantë të ligjit, të tilla si e drejta afariste, civile, penale ose e drejta e të miturve. Avokatët zakonisht përfaqësojnë dhe mbrojnë klientët e tyre në procedurat juridike. Avokati hollësisht hulumton çështjet e klientëve që t'u mundësojë të gjejnë zgjidhje të ndryshme për çështjen ose problemin. Avokati gjithashtu mund të marrë rolin e konsulentit ligjor. Një konsulent nga një kompani avokatie ndihmon dhe këshillon firmat juridike. Përdorimi i ekspertizës së tij në këshillimin ligjor dhe të biznesit

konsulenti mund të ndihmojë shumë në rritjen e biznesit, sepse në kuadër të biznesit do të ketë strategji që do të ndihmojnë të përqendrohen në punën e tyre.

2. Koncepti dhe karakteristikat konsulencës juridike dhe shërbimeve të avokatisë

Shërbimet juridike konsulente dhe shërbimet e avokatisë zakonisht përcaktohen si kryerja dhe zbatimi i parimeve ligjore në një situatë praktike dhe faktike. Ato përfshijnë zbatimin e parimeve juridike në drejtim të parashikimit efikas të zgjidhjeve specifike të çështjeve juridike dhe dhënies së kaheve, konsultime dhe rekomandime për të ndërmarrë veprime nga ai ose ata që janë në një shqyrtim juridik, si mjet për zgjidhjen e çështjeve juridike. Shërbimet juridike konsulente dhe shërbimet e avokatisë përfshijnë dhënien e sugjerimeve ose parashikimin e veprimeve që duhet të ndërmerren duke u bazuar në një vlerësim të situatës praktike juridike në të cilën ndodhet një person ose një subjekt. Kjo nënkupton dhënien e një mendimi formal në lidhje me një çështje apo të një procedure të caktuar juridike nga një përfaqësues i caktuar ligjor ose avokat. Shërbimet juridike konsulente dhe shërbimet e avokatisë përfshijnë⁷⁸:

- Ofrimi i këshillave juridike
- Themelimi i subjekteve afariste, ndryshime të subjektet, procedurat për likuidim,
- Përpilimin e padive, ankesave, lutjeve, parashtresave dhe shkresave të tjera në procedurat për marrëdhënie obligative, familjare, pronësore, trashëgimore, pune dhe afariste.
- Përpilimi i kontratave, testamenteve, deklaratave dhe dokumenteve të tjera,
- Përfaqësimi i personave fizik dhe juridik para gjykatave dhe para organeve të tjera shtetërore, ndërmarrjeve dhe personave të tjerë juridikë,

⁷⁸ The free dictionary by Farlex. Consultation practice, (2020),
<http://legaldictionary.thefreedictionary.com/consultation>

- Përfaqësimi i personave fizik dhe juridik në çështjet e tyre juridike për lidhjen e kontratave dhe nivelimi. Shërbimet juridike konsulente sipas fushës në drejtësi kryhen si shërbime në:
 - ✓ Të drejtën civile (çështje nga fusha pronësore, civile, sendore);
 - ✓ E drejta obligative (përgatitja e kontratave, para kontratave, propozim - kontratave, anekseve, deklaratave dhe marrëveshjeve);
 - ✓ Trashëgimisë (parashtrimi i kërkesave për ngritjen e procedurës së trashëgimisë, si dhe këshilla, nxjerrjen e dokumenteve dhe ndihmë rreth procedurës së trashëgimisë);
 - ✓ Procedura për privatizimin e tokës dhe legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje, procedura të tjera para Agjencisë së Kadastrës së patundshmërisë;
 - ✓ E drejta tregtare (çështje ekonomike);
 - ✓ E drejta e falimentimit (falimentimi, likuidimi i firmës);
 - ✓ Regjistrimi i firmave, çdo lloj ndryshimi tek subjektet juridike, shoqatat e qytetarëve, zyra të përfaqësive, filialeve;
 - ✓ E drejta penale;
 - ✓ Përfaqësimi dhe ndihmë juridike personave fizik dhe juridik në gjykata, në organe gjyqësore, komuna, institucione shtetërore;
 - ✓ E drejta e punës (përgatitja e kontratave për punësim, kontrata për menaxherë, marrëveshje për përfundimin e marrëdhënies së punës, vendime për heqjen dorë nga kontrata për punësim, statuteve, rregulloreve, vendimmarrjeve, aktvendimeve, paraqitjen dhe ç'lajmërimin e të punësuarve në Agjencinë për Punësim të RM-së, procedurave për punësimin e shtetasve të huaj, përfaqësimi para gjykatave të Republikës së Maqedonisë për kontestet e punës);

- ✓ E drejta administrative (përfaqësimi para ministrive, komunave, Gjykatës Administrative);
- ✓ E drejta për sigurim (përfaqësimi para kompanive të sigurimit dhe para gjykatave për kompensim të dëmit);

Shërbimet juridike konsulente dhe shërbimet e avokatisë në bazë mund të ndahen në tre grupe edhe atë:

- ✓ Konsultime juridike dhe këshillime;
- ✓ Përpilimi i akteve dhe shkresave (kundërshtime, padi, ankesa dhe të ngjashme); dhe
- ✓ Përfaqësimi para gjykatave.

Shërbimet juridike konsulente dhe shërbimet e avokatisë kanë këto karakteristika⁷⁹:

- Shërbimet juridike i përkasin grupit të veprimtarive të mbrojtura të cilat kryhen nga persona që kryejnë punë të autorizuar ligjore vetë të rregulluar, avokatë,
- Njohuritë dhe mjetet juridike janë të paarritshme pa përfshirjen e një avokati,
- Avokatët rregullojnë tregun duke ndjekur një politikë të eliminimit të konkurrencës jo-avokate,
- Avokatët konkurrojnë me njëri-tjetrin,
- Pjesa më e madhe e shërbimeve të avokatëve janë shumë të kushtueshme,
- Teknologjia e punës së avokatëve është e qëndrueshme duke ofruar shërbime konvencionale ose tradicionale,
- Njohuritë juridike janë akademike.

⁷⁹ Cornell University Law School. [Future of legal services and the development of legal Knowledge Management](http://blog.law.cornell.edu/voxpath/2013/08/30/future-of-legal-services-and-the-development-of-legal-knowledge-management/comment-page-1/)., <http://blog.law.cornell.edu/voxpath/2013/08/30/future-of-legal-services-and-the-development-of-legal-knowledge-management/comment-page-1/>

3. Konsultime juridike dhe këshillime

Pavarësisht nga madhësia, çdo kompani mund të përballet me shumë probleme të ndryshme ligjore gjatë funksionimit të saj. Për t'u marrë me këto probleme, disa pronarë të bizneseve punësojnë avokatë për konsultime, për t'i ndihmuar ata të kuptojnë situatat ligjore dhe të reagojnë në mënyrë adekuate. Detyrat e një avokati konsulent ndryshojnë bazuar në nivelin e tij të përfshirjes në biznes. Konsultimet dhe këshillat juridike në praktikën e shërbimeve të konsulencës juridike paraqiten si konsulta të përgjithshme dhe këshilla ligjore në fushat e punës së shoqatave tregtare, përkatësisht ndërmarrjeve. Një avokat për konsultime biznesi zakonisht siguron këshilla juridike në fusha të ndryshme të së drejtës së biznesit, duke përfshirë⁸⁰:

- ✓ Ligjin për punësim,
- ✓ Ligji për pagat dhe punën jashtë orarit,
- ✓ Ligji për marrëdhëniet e punës,
- ✓ Licencimi dhe e drejta administrative.

Një avokat për konsultime mund të rishikojë praktikën e kompanisë për tu siguruar që ato janë në përputhje me të gjitha ligjet në fuqi të punës dhe pagave, duke përfshirë edhe ato që rregullojnë pagat minimale, orët shtesë dhe pushimet e vakteve. Një pronar biznesi gjithashtu mund t'i drejtohet një avokati për këshilla për një çështje të veçantë, siç është ligjshmëria e një vendimi për punësim ose pushimit nga puna. Avokatët konsulentë shpesh mbrojnë kompani në procedurat juridike. Për shembull, nëse një punëtor paraqet padi për diskriminim ose shkelje të ligjit të punës, avokati mund të përfaqësojë kompaninë kundër punëtorit. Në mënyrë të ngjashme, një avokat konsulent i biznesit gjithashtu mund ta mbrojë atë në paditë e ngritura nga ish-klientë ose biznese

⁸⁰ McMullen, A., (2020), Duties of a Consulting Lawyer at a Business | Small Business ...smallbusiness.chron.com › du.

të tjera. Kjo detyrë zakonisht përfshin hulumtime të thelluara, përgatitjen e argumentit mbrojtës dhe dorëzimin e argumentit në gjykatë.

Shërbimet konsulente juridike në lidhje me këshillat juridike të kompanive mund t'i referohen këshillave të kompanive për çështje në fushën e strukturës së tyre organizative, në aspektin e rregulloreve juridike, tatimore dhe rregulloreve të tjera, pastaj këshilla për bashkëngjitjen dhe marrjen e kompanive, si dhe privatizimet, ndihmë juridike gjatë evoluimit, vlerësimi i aftësisë së ndërmarrjeve që merren, si dhe planifikimi strukturor, bazuar në parallogaritje tatimore dhe në baza të veçanta rregullatore, si dhe këshilla në procedurat e likuidimit dhe falimentimit.

Shërbimet e konsulente juridike kryhen gjithashtu brenda aktiviteteve të korporatave si shërbime në fushën e të drejtës së korporatave, të tilla si përgatitja e marrëveshjeve komerciale, akteve të brendshme, rregulloreve, marrëveshjeve kolektive, vendimeve, përgatitjes së skenarëve për mbajtjen e mbledhjes së aksionarëve dhe bordit të drejtorëve, si dhe zbatimin e tyre, ndihmë juridike dhe mbështetja e sektorit juridik të komitentit - person juridik, zbatimi i procedurave disiplinore, zhvillimi i sistemeve specifike për avancim, mbajtja e sekretit të biznesit dhe zhvillimi i besnikërisë së punonjësve, ndihma në menaxhmentin e burimeve njerëzore dhe përgatitjen e kontratave menaxheriale.

Shërbimet konsulente juridike realizohen gjithashtu si ofrimi i këshillave mbi të drejtat e pronës industriale, duke përfshirë regjistrimin e të drejtave autoriale, markat tregtare, brendet, të drejtat e dizajnit, të drejtat e softuerit, know-how, të drejtat e pronësisë industriale dhe brendet e certifikuara. Këto këshilla zbatohen si këshilla për klientët për të zhvilluar strategji efektive për identifikimin, mbrojtjen dhe shfrytëzimin e këtyre të drejtave dhe identifikimin e produkteve të falsifikuara dhe abuzimin e të drejtave, si dhe nisjen e procedurave të nevojshme për eliminimin e tyre nga tregu.

Shërbimet konsulente juridike realizohen nga kryerësit e shërbimeve konsulente juridike dhe shërbimeve avokatie në të gjitha sferat e ligjit të punës dhe marrëdhënieve të punës. Ato konsistojnë në interpretimin e rregulloreve ligjore, këshillime në fushën e

marrëdhëniet e punës në lidhje me të drejtat e punëtorëve dhe punëdhënësve, zbatimin dhe udhëheqjen e procedurave disiplinore, përpilimin e kontratave të punës dhe kontratave menaxheriale, lajmërimin dhe ç'lajmërimin e punëtorëve dhe procedura të tjera para organeve administrative dhe gjyqësore.

Shërbimet konsulente juridike në të drejtën e biznesit kryhen si shërbime në të drejtën tregtare, të drejtën e kontratave dhe dëmshpërblimeve, të drejtën financiare, të drejtën e letrave me vlerë, të drejtën e investimeve, të drejtën bankare, të drejtën e patundshmërive, të drejtën doganore dhe tatimore. Këto shërbime përfshijnë dhënien e mendimeve nga ekspertë për pjesëmarrje dhe aksione, udhëheqje korporative, hulumtimin e tregut, investimet dhe fondet e investuese, transferimin e parave, sigurimin e kërkesave.

4. Përpilimi i akteve dhe parashkresave

Shërbimet e avokatisë që kanë të bëjnë me hartimin e akteve dhe parashkresave janë të lidhura me çështje që kanë të bëjnë me regjistrimin dhe dorëzimin e aplikimeve për themelimin e shoqatave dhe personave të tjerë juridik, ndryshime të ndryshme organizative të natyrës së korporatave, paraqitjen e të punësuarve, regjistrimin për TVSH-në, hapjen e llogarive dhe aktivitete të tjera të nevojshme për fillimin e funksionimit të një ndërmarrje të re, gjegjësisht shoqatë. Ky grup i punëve përfshin gjithashtu çështje që kanë të bëjnë me përgatitjen e para kontratave, kontratave, anekse të kontratave, deklaratave, marrëveshjeve për nevojat e klientit, pastaj përgatitjen e statuteve, rregulloreve, vendimeve, aktvendimeve, paralajmërimeve dhe të ngjashme.

Përgatitja e akteve të përgjithshme si shërbime juridike të kryerësve të shërbimeve konsulente juridike dhe shërbimeve avokatie, përfshin përgatitjen e rregulloreve për marrëdhëniet e punës, procedurën disiplinore, sistematizimin e vendeve të punës, sekretin e biznesit, statutet, vendimet në fushën e marrëdhëniet të punës. Si akte nga ana e zyrave konsulente ligjore dhe avokatie si dhe shoqatat e avokatëve ose individëve,

përfshihen gjithashtu përgatitja e kontratave të shitblerjes, paradhënieve, hipotekave, marrëveshjeve për kredi, etj.

Avokatët mund ta ndihmojnë kompaninë që të sigurohet se dokumentet e biznesit janë në rregull dhe se biznesi është i mbrojtur. Avokatët mund të ndihmojnë në përgatitjen e⁸¹:

- ✓ Dokumenteve për themelim,
- ✓ Kontratave të punës,
- ✓ Kontratave për qira
- ✓ Kontrata sigurie
- ✓ Kontratave për furnizim,
- ✓ Kontratave për shitblerje,
- ✓ Kontratave jo konkurruese,
- ✓ Përgatitja e librave të korporatave
- ✓ Akteve nënligjore.

5. Përfaqësimi

Çështjet e përfaqësimit kanë të bëjnë me përfaqësimin e përhershëm dhe të plotë dhe ndihmën juridike të ndërmarrjeve të prodhimit dhe të tregtisë, instituteve dhe ndërmarrjeve, zbatimin e procedurës së falimentimit dhe likuidimit, përfaqësimin para kompanive të sigurimit për kërkesat për kompensim të dëmit, përfaqësimin para gjykatave në çështjet e kompensimit të dëmit, në kontestin e marrëdhënies së punës, kontestet civile, penale dhe familjare, përfaqësimi para ministrive, komunave, agjencive qeveritare dhe organeve të tjera, përfaqësimi para Gjykatës Administrative në konteste administrative.

⁸¹ Business Document Preparation | Schlueter, Mahoney & Ross, (2020), www.smrlaw.net › business-d.

Përfaqësimi i avokatëve grupohet sipas llojeve të ndryshme të së drejtës, edhe atë:

- E drejta familjare,
- Ligji i trashëgimisë,
- Marrëdhëniet pronësore dhe pronësore-juridike,
- Marrëdhëniet obligative
- Marrëdhëniet e punës.

6. Pozicionimi për kryerjen e shërbimeve konsulente juridike dhe shërbimeve të avokatisë

Pozicionimi është një proces i zhvillimit të vetëdijes së klientëve për një çështje të veçantë juridike që duhet ta zgjedhin. Pozicionimi gjithashtu përfshin edhe përforcimin e perceptimit të klientëve për përvojën që kanë gjatë zgjedhjes së shërbimeve konsulente. Pozicionimi efektiv mund të arrihet nëse e njohim konkurrencën shumë mirë dhe avantazhet që mund t'u ofrohen klientëve. Pozicionimi kërkon përcaktimin e avantazheve personale diferenciale që e bëjnë konsulentin të ndryshëm dhe me një vlerë më të lartë se ato të konkurrentit⁸².

Pozicionimi mund të arrihet në raport me konkurrentët, për sa i përket llojit të shërbimeve dhe karakteristikave të tyre dhe në lidhje me çmimin dhe karakteristikat e shërbimeve. Gjatë pozicionimit duhet të merren parasysh faktorët e mëposhtëm⁸³:

- konkurrenca,
- blerësit,
- imazhi i kompanisë,
- tregu i synuar,

⁸² Small Biz Connect. Market Analysis, Segmentation, Targeting, Positioning., (2014), <http://toolkit.smallbiz.nsw.gov.au/part/3/10/49>

⁸³ Rosagrata, J. (2004). Market segmentation, targeting and positioning, Chapter 4. McGraw-Hill, Australia

- miks marketingu

Pas vlerësimit të llojeve të ndryshëm të klientëve, zyra e konsulentës juridike ose zyra e avokatisë ose individit duhet të vendosin se cilat dhe sa lloje ose segmente të veçanta do të shërbejnë. Ky është i ashtuquajti *pozicionim i tregut* - përzgjedhja e tregut të synuar i cili përbëhet nga një grup klientësh të cilët kanë nevoja ose karakteristika të përbashkëta që vendosin t'i shërbejnë.

Çelësi për të fituar dhe mbajtur klientët e shërbimeve të konsulencës ligjore dhe të avokatisë është të kuptuarit e nevojave të tyre dhe përmbushja e tyre më mirë se konkurrentët, duke u dhënë atyre më shumë vlerë. Pozicionimi mund të arrihet duke ofruar shërbime që kanë një vlerë superiore, qoftë përmes çmimeve më të ulëta sesa i konkurrentëve ose përmes përfitimeve më të mëdha që do të justifikojnë çmimet e larta.

Pozitat e forta nuk ndërtohen me premtime të zbrazëta. Nëse zyra e konsulentës juridike ose zyrës së avokatisë i pozicionon shërbimet e saj si oferta të cilësisë dhe shërbimit më të mirë, atëherë ajo duhet të ofrojë cilësinë dhe shërbimin e premtuar. Kjo është arsyeja pse pozicionimi fillon me diferencimin e ofertës së tregut.

Pozicionimi i shërbimet juridike konsulente dhe avokatie duhet të paraqet proces i përcaktimit të variablave të miks marketingut, përmes të cilave klienti do të fitojë një imazh më të qartë, më të ndryshëm dhe të dëshiruar të asaj se çka përfaqëson ofruesi specifik i shërbimeve juridike konsulente dhe shërbimeve të avokatisë, individit ose zyra, në krahasim me konkurrentët. Pozicionimi është mënyra se si, kryerësi i shërbimeve konsulente juridike dhe shërbimeve avokatie, bazuar në disa elemente ose karakteristika të caktuara, shihet nga klientët në raport me konkurrentët.

Pozicionimi në të vërtetë nënkupton krijimin e një imazhi në vetëdijen e klientit për atë se çka prezanton një ofrues ose kryerës i shërbimeve konsulente juridike dhe shërbimeve të avokatisë. Pozicionimi nuk mund të jetë arbitrar, por përkundrazi ai duhet të përfshihet që nga dizajnimi i shërbimeve, duke përfshirë përdorimin e mjeteve të miks

marketingut në kombinime të ndryshme gjatë së cilës duhet zgjedhur një nga cilësitë që duhet të ngelë në vetëdijen e klientëve.

Jo çdo ofrues i shërbimeve konsulente juridike mund të gjejë shumë mundësi për të diferencuar ofertën e tij të shërbimeve, që do t'u japë atyre avantazh ndaj konkurrentëve. Prandaj, duhet të pranojë një strategji reale të pozicionimit që do të plotësojë nevojat e klientëve të saj të synuar, duke marrë parasysh qëllimet e veta, konkurrencën, planet e zgjerimit, nevojat personale, llojin e punës së kryer, llojin dhe numrin e klientëve.

7. Planifikimi i kryerjes së shërbimeve konsulente dhe shërbimeve të avokatisë

Planifikimi i kryerjes së shërbimeve konsulente juridike dhe të avokatisë, në vetë përfshin aktivitete në lidhje me hulumtimin dhe parashikimin e nevojave të klientit, marrjen e vendimeve për qëllimet themelore, politikën, strategjinë, taktikën dhe planet individuale të marketingut që duhet të sigurojnë kënaqësinë e nevojave, rritjes dhe zhvillimit të identifikuar të kryerësit - ofruesit të shërbimeve konsulente juridike dhe shërbimeve të avokatisë.

Procesi i planifikimit të kryerjes së shërbimeve konsulente juridike dhe avokatie, nëse perceptohet në thelb, përfshin këto elementet⁸⁴:

- ✓ analiza e mundësive të tregut;
- ✓ zgjedhja e tregut të synuar;
- ✓ vendosjen e qëllimeve të marketingut;
- ✓ përpunimin e marketing programit, dhe
- ✓ zbatimin dhe kontrollin e aktiviteteve të marketingut.

⁸⁴ Legal services plans - FREE Legal Information | Legal Line, (2020), www.legalline.ca › pre-paid-l

Analiza e mundësive të tregut është detyra e parë në procesin e planifikimit të kryerjes së shërbimeve të konsulencës juridike dhe shërbimeve të avokatisë, e cila përbëhet nga analiza e mundësive afatgjate të tregut, si dhe nga analiza e mjedisit makro dhe mikro marketingut.

Mikro-mjedisin e kryerësve të shërbimeve të konsulencës juridike dhe shërbimeve të avokatisë e përbëjnë të gjithë faktorët që ndihmojnë ose ndikojnë në aftësinë për të ofruar shërbime të konsulencës juridike, ndërsa makro-mjedisi përfshin tendencat në fushën e zhvillimit demografik, sistemin juridiko-politik dhe të tjera.

Në fushën e kërkimit dhe përzgjedhjes së tregjeve të synuara, kryerësit e shërbimeve konsulentë juridike duhet ta njohin tregun e përgjithshëm të shërbimeve konsulentë juridike, segmentet e këtij tregu dhe të bëjnë një zgjedhje të segmentit më të përshtatshëm.

Strategjitë ndihmojnë kryerësit e shërbimeve konsulente juridike dhe shërbimeve të avokatisë të harmonizojnë kryerjen e aktiviteteve me të cilat do të realizohen qëllimet e përcaktuara. Me strategjitë, ata ripërcaktojnë rregullat e zhvillimit të luftës konkurruese dhe rrisin efikasitetin operativ dhe arrijnë një përfitim të caktuar.

Në kushtet e vazhdimësisë së ndryshimeve në rrethinë, realizimi i aktiviteteve duhet të harmonizohet vazhdimisht, me qëllim të ruajtjes së pozicionit konkurrues dhe për të arritur sukses. Në mënyrë që të ruhet potenciali ekzekutiv, duhet të njihen të gjitha elementet e strategjisë dhe aktivitetet e saj dinamike t'i përshtaten ndryshimeve. Për tu arritur përfitimi i dëshiruar dhe për të ruajtur dhe forcuar pozicionet e tregut, duhet të arrihet efikasiteti i integruar operativ i të gjithë elementeve të strategjisë. Për të arritur këtë, bëhen kombinime të strategjive, avancohen proceset, zhvillohet struktura organizative, përsoset teknologjia. E gjithë kjo është bërë për t'iu përgjigjur kërkesave të klientëve dhe për të arritur qëllimet e dëshiruara.

Kur planifikohet kryerja e shërbimeve juridike konsulente dhe shërbimeve të avokatisë, duhet të përgjigjen disa pyetje:

- ✓ ku jemi tani,
- ✓ ku duam të arrijmë,
- ✓ si të realizojmë qëllimet e përcaktuara,
- ✓ kur duam të realizojmë qëllimet e përcaktuara,
- ✓ kush është përgjegjës për kryerjen e qëllimeve të përcaktuara,
- ✓ Sa resurse janë të nevojshme për të arritur qëllimet e përcaktuara.

Plani për kryerjen e shërbimeve juridike konsulente dhe shërbimeve e avokatisë përcakton misionin, vizionin dhe qëllimet që dëshirohen të arrihen në periudhën e ardhshme. Ky është një proces, me të cilin kryerësi ose ofruesi i shërbimeve konsulente juridike dhe të avokatisë, duhet t'ia arrijë të jetë i njohur dhe i ndryshëm nga të tjerët dhe të përqendrohet në kryerjen e detyrave të caktuara në mënyrë që të plotësojë nevojat e klientëve dhe të bëjë një fitim. Plani i kryerësit ose ofruesit të shërbimeve konsulente juridike dhe të avokatisë, është i vetmi për realizimin e biznesit të tij. Çelësi për përgatitjen e një plani të suksesshëm është:

- ✓ përcaktimi i strategjisë zhvilluese të kryerësit ose ofruesit të shërbimeve konsulente juridike dhe të avokatisë,
- ✓ Përcaktimi i vëllimit të pritur të fitimit,
- ✓ monitorimi i vazhdueshëm i kryerjes së shërbimeve konsulente juridike,
- ✓ futja e teknologjive të reja të punës në mënyrë që të rritet efektiviteti dhe efikasiteti i punës,
- ✓ sigurimi i reagimeve të klientëve.

Funksionimi i suksesshëm i shoqatave për konsulencë juridike dhe shoqatave të avokatisë dhe individëve ose kompanive, nënkupton funksionimin dhe zhvillimin e një game të gjerë fushash pune, duke ofruar ndihmë juridike që është përgjigje e nevojave të klientëve. Në portofolin e punëve të cilat i kryejnë firmat për konsulencë juridike dhe firmat për avokati ose individë, është e nevojshme të sigurohet një listë e larmishme e klientëve, korporatave, ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla dhe individëve të cilëve do

t'u kushtojë të njëjtin nivel ekspertize dhe profesionalizmi në zgjidhjen e problemeve të tyre juridike.

Puna e kryerësve të shërbimeve konsulentë juridike dhe avokatie duhet të përqendrohet në ofrimin e shërbimeve të plota juridike. Përmes aktiviteteve të përditshme dhe shërbimeve që ata ofrojnë, ata duhet të ofrojnë siguri ligjore dhe financiare për klientët, si dhe një nivel të lartë të shërbimeve profesionale. Çdo zyrë apo shoqatë për shërbime konsulente juridike dhe avokatie duhet të zhvillojë dhe kryejë shërbime sipas të cilave do të jetë ndryshe nga të tjerat. Kjo mund të arrihet duke përmirësuar dhe duke përsosur vazhdimisht metodologjinë e punës, duke rritur listën e klientëve të kënaqur dhe duke futur shërbime të reja, përmes pozicionimit të suksesshëm dhe shpërndarjes së vazhdueshme të rezultateve të shkëlqyera tek klientët.

Për çdo ofrues të shërbimeve konsulentë juridike dhe avokatie, në radhë të parë duhet të jetë klienti, integriteti, konfidencialiteti, puna në ekip, mendimi konstruktiv dhe kritik, zgjidhja e problemeve, efikasiteti dhe ekonomizimi.

Njerëzit me të cilët punon kryerësi i shërbimeve konsulente juridike dhe avokatie, nuk duhet të shihen vetëm si klientë, me ata duhet të ndërtohen marrëdhënie partneriteti. Çdo herë duhet të zgjidhet zgjidhja më e mirë ligjore, sepse suksesi në punë është i lidhur në mënyrë të pashmangshme me suksesin e partnerëve. Produkti ose shërbimi që u ofrohet klientëve duhet të jetë rezultat i njohurive, të menduarit dhe punës së palodhur.

Edhe në një profesion tradicional siç janë shërbimet konsulent juridike dhe shërbimet e avokatisë, teknologjia ka fuqinë e mjaftueshme për të krijuar shumë vende pune, të cilat do të ofrojnë një lloj të ri të shërbimeve konsulentë juridike dhe shërbimeve të avokatisë. Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë për konsulentët ligjorë dhe avokatët siguron më shumë punë në fushën e pronës intelektuale, privatësisë, si dhe patentimit të softuerëve të rinj dhe metodave të biznesit.

Duke pasur parasysh që teknologjia zhvillohet më shpejt sesa jurisprudenca, kompanitë e teknologjisë kanë nevojë për këshilla juridike që t'u tregojnë atyre se atë që po e bëjnë është në përputhje me legjislacionin ekzistues, si dhe këshilla juridike dhe avokatë, të cilët do t'i sigurojnë informacionet më të fundit juridike dhe të cilët do të interpretojnë të drejtën për produktet e reja. Për këtë lloj pune, jo vetëm që duhet të njihet mirë jurisprudenca – por gjithashtu duhet të dihet se si funksionojnë bizneset nga pikëpamja teknologjike.

De rregullimi i ofruesve të shërbimeve juridike do të thotë që një gamë më e gjerë e organizatave mund të ofrojnë shërbime ligjore. Dhe për shkak se biznesi dhe ligji përplasen, punëdhënësit kanë më shumë nevojë për avokatë me takt teknologjik dhe shpirt sipërmarrës. Shumë firma të reja juridike sot punojnë online, klientët sot flasin me një avokat në internet, njëjtë sikur atë ta bënin vetë. Firmat e tilla juridike kërkojnë juristë, të cilët, përveç të drejtës, e njohin mirë teknologjinë, dhe më pas i aftësojnë ata për të fituar aftësitë e nevojshme në marketing dhe biznes.

Në kushtet moderne të punës, është e patjetërsueshme që çdo ofrues i shërbimeve konsulente juridike dhe shërbimeve të avokatisë, të ketë mundësi më të mëdha në ofrimin e shërbimeve të tilla në zona të ndryshme. Klientët duhet të sigurohen që të marrin një gamë të gjerë shërbimesh, ndihmë juridike të mbështetur nga praktika dhe një nivel të lartë shërbimesh cilësore në fushën juridike dhe të kenë një ekip të bashkëpunëtorëve dhe specialistëve më profesionistë.

8.Konkluzion

Shërbimet konsulente juridike dhe të avokatisë zakonisht përcaktohen si ekzekutimi dhe zbatimi i parimeve të së drejtës në një situatë praktike dhe faktike. Ato përfshijnë zbatimin e parimeve të së drejtës në drejtim të parashikimit efikas të zgjidhjeve specifike të çështjeve juridike dhe dhënies së kaheve, konsultimeve ose

rekomandimeve mbi rrugën e veprimit të ndërmarrë nga ai ose ata që janë në një mosmarrëveshje ligjore si një mjet për zgjidhjen e çështjeve juridike.

Detyrat e kryerësit të shërbimeve konsulente juridike dhe shërbimeve të avokatisë duhet të inkurajojnë sjelljet emocionale dhe motivuese të atyre që kryejnë shërbimet, të kuptohen lehtë nga të gjithë dhe të jenë në gjendje të nxisin lehtësisht veprimin, gjegjësisht të jenë një mjet praktik me ndihmën e të cilit mund të shihet se si duhet të punohet për të arritur qëllimet e përcaktuara, të jetë në gjendje të matë konkurrencën dhe të përcaktojë avantazhet konkurruese dhe të dijë të shkojë përpara në kushtet e një konkurrence të fortë dhe cilat janë avantazhet e shërbimeve në krahasim me ato të konkurrencës.

Në një botë të globalizuar, në të cilën konkurrenca është e fortë, është gjithnjë e më e rëndësishme për çdo kryerës të shërbimeve konsulente juridike dhe avokatie të zhvillojë shërbime të njohura, gjegjësisht karakteristika të veçanta që do ta dallojnë atë nga konkurrentët. Njerëzit me të cilët punon kryerësi i shërbimeve konsulente dhe avokatie nuk duhet të shihen vetëm si klientë, me ata duhet të ndërtohen marrëdhënie partneriteti.

Një kryerës i shërbimeve konsulente dhe avokatie gjatë punës së tij nuk duhet të kopjojë të tjerët, por duhet të kërkojë dhe të gjejë mënyra për t'u dalluar nga konkurrentët e tij, d.m.th. t'ia arrijë që zyra e tij ose shoqata e avokatisë të bëhet e njohur me atë që ofron (shërbime unike, punon me grupe të vetme klientësh, zhvillon një strategji të ndryshme të ofrimit të shërbimeve, ka stilin e vet personal). Ky është procesi i ndërtimit dhe krijimit të një brendi të një firme konsulente juridike ose firmë avokatie.

Literatura

- Business Document Preparation | Schlueter, Mahoney & Ross, (2020), [www.smrlaw.net > business-d](http://www.smrlaw.net/business-d).

- Catapano, C. (2014). The Law Firm Strategic Plan – How to improve growth & profits per partner. Bridgesphere., <http://bridgesphere.com/law-firm-strategic-plan-improving-profits-per-partner/#sthash.6b5qWNMr.dpuf>
- Cornell University Law School. Future of legal services and the development of legal Knowledge Management., <http://blog.law.cornell.edu/voxpath/2013/08/30/future-of-legal-services-and-the-development-of-legal-knowledge-management/comment-page-1/>
- Legal services plans - FREE Legal Information | Legal Line, (2020), [www.legalline.ca › pre-paid-1](http://www.legalline.ca/pre-paid-1)
- McMullen, A., (2020), Duties of a Consulting Lawyer at a Business | Small Business, [smallbusiness.chron.com › du](http://smallbusiness.chron.com/du)
- Rosagrata, J. (2004). Market segmentation, targeting and positioning, Chapter 4. McGraw-Hill, Australia
- Small Biz Connect. Market Analysis, Segmentation, Targeting, Positioning., (2014), <http://toolkit.smallbiz.nsw.gov.au/part/3/10/49>
- The free dictionary by Farlex. Consultation practice, (2020), <http://legaldictionary.thefreedictionary.com/consultation>.

ZHVILLIMI DHE PLANIFIKIMI I MENAXHIMIT TË RESURSEVE NJERËZORE NË SEKTORIN BANKAR

MSc. Semra BUJARI

International University of Struga (s.bujari@eust.edu.mk)

MSc. Reazarta MAMUDI

International University of Struga (r.mamudi@eust.edu.mk)

Abstrakt

Menaxhimi i burimeve njerëzore është procesi i menaxhimit të njerëzve në organizata në një mënyrë të strukturuar dhe të plotë. Kjo mbulon fushat e personelit (punësimit), selektimit të njerëzve, caktimit dhe menaxhimit të pagave, menaxhimit të performancës, mënyrën e organizimit të resurseve njerëzore, orientimin në vendin e punës, udhëheqjen e problemeve dhe ndryshimeve në resurse njerëzore. Funkcioni i menaxhimit të burimeve njerëzore përveç aktiviteteve për punësimin e njerëzve, trajnimin dhe zhvillimin e tyre përfshijnë gjithashtu menaxhimin e qasjes në përfitimet dhe shpërblimet e punonjësve, regjistrat e punonjësve dhe politikat e personelit. Burimet njerëzore përqendrohen në maksimizimin e produktivitetit të punonjësve, si dhe zbatimin e politikave dhe proceseve në organizatë. Menaxhimi i burimeve njerëzore ndryshon dhe përmirësohet vazhdimisht, i ndjekur nga sfida dhe ndryshime të shpeshta në biznes. Është bërë e qartë se punonjësit, pa marrë parasysh se çfarë pune bëjnë, nuk mundohen të kryejnë vetëm detyrat që janë nën kompetencat e tyre dhe të paguhet për ata, por ata punojnë për të treguar aftësitë e tyre.

Menaxhimi i burimeve njerëzore është një nënsistem i rëndësishëm i çdo kompanie, gjithashtu edhe i bankave. Industria bankare është një superfuqi shumë e rregulluar që stabilizon mjedisin ekonomik të vendeve në botë. Bankat ruajnë informacione të rëndësishme, personale në lidhje me klientët e tyre, kurse bankat komerciale kanë inventar të vlefshëm - paratë. Punonjësit e bankës, nga menaxherët te komercialistët, duhet të kenë një nivel më të lartë integriteti dhe besimi sesa punonjësit në shumicën e industrive të tjera, gjë që e bën rolin e burimeve njerëzore në sektorin bankar shumë më të rëndësishëm. Sektori bankar është rritur nga disa institucione të përfshira kryesisht në pranimin e depozitave dhe financimin e familjeve dhe bizneseve në një treg kompleks me shumë pjesëmarrës, ku shumë banka komerciale, institucione financiare dhe banka të specializuara ofrojnë një larmi produktesh dhe aktivitesh. Pothuajse çdo bankë dhe institucion financiar është i përfshirë në funksione të ndryshme në vendin e punës dhe kështu kërkon një ekip shumë efikas dhe fuqi punëtore adekuate. Ashtu si shumë sektorë të tjerë të organizuar, sektori bankar kërkon një forcë punëtore shumëplanëshe për kërkesat e saj të ndryshme profesionale dhe të personelit.

Fjalë kyçe: *menaxhim, banka, organizata, fuqi punëtore, procese, produktivitet.*

1. Hyrje

Zhvillimi i burimeve njerëzore është një proces i rritjes së kapacitetit të burimeve njerëzore përmes zhvillimit. Zhvillimi i burimeve njerëzore është diçka që e bëjnë të gjithë. Individët e bëjnë atë përderisa punojnë për tu zhvilluar, menaxherët e bëjnë për të mbështetur zhvillimin e njerëzve të tjerë sepse krijojnë mjetet e përgjithshme të zhvillimit për një organizatë. Kështu, është një proces i shtimit të vlerës së individëve, ekipeve dhe organizatës si një sistem të tërësishëm organizativ. Zhvillimi i burimeve njerëzore mbështetet në angazhimin e njerëzve dhe aftësimin e tyre për të përdorur fuqitë e tyre për të zhvilluar organizatën që i përketin dhe shoqërisë në tërësi. Duke pasur parasysh rëndësinë e burimeve njerëzore, ato tani trajtohen si pasuritë më të vlefshme

për mbijetesën e një organizate. Zhvillimi i burimeve njerëzore përfshin zhvillimin e njerëzve dhe zhvillimin e një organizate.

Menaxhimi i burimeve njerëzore, si funksion i rëndësishëm, është një proces jashtëzakonisht kompleks dhe shumëdimensional.

Marrëdhëniet midis punëdhënësve dhe punëtorëve të ushqyera për mijëra vjet, ngadalë u lëshojnë vendin marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe zgjidhjes të qëllimeve, duke ngritur personalitetin, integritetin dhe iniciativën e punonjësit në një nivel më të lartë. Punonjësit jo vetëm që punësohen për të kryer detyrat e tyre në mënyrë të vazhdueshme dhe për një pagë, por edhe për të treguar cilësinë dhe identitetin e tyre.

Asnjë organizatë nuk mund të punojë me sukses pa burime njerëzore cilësore. Ky pretendim është veçanërisht i rëndësishëm për bankat dhe organizatat e tjera të shërbimeve ku shumë punonjës vijnë në kontakt me klientët çdo ditë. Megjithatë shumica e bankave përshkruajnë mënyrën e ndërveprimit të punonjësve me klientët, efekti varet drejtpërdrejt nga qëndrimi i organizatës ndaj punonjësve, prej ku rezulton ndjenja e përkatësisë dhe kënaqësisë në vendin e punës.

2. Planifikimi I resurseve njerëzore në sektorin bankar

Planifikimi i burimeve njerëzore është një proces që kërkon të sigurojë njerëzit e duhur në vendin e duhur dhe në kohën e duhur, të aftë për të kryer me sukses detyrat e tyre. Qëllimi i planifikimit është miratimi i një plani si bazë për angazhimin e burimeve njerëzore në mënyrë që të realizohen me sukses qëllimet e organizatës. Çdo plan i burimeve njerëzore duhet të jetë në përputhje me strategjinë e organizatës për arritjen dhe ruajtjen e një avantazhi konkurrues.




Figura 1. Planifikimi I resurseve njerëzore

Planifikimi i resurseve njerëzore nënkupton parashikimin në kohë të nevojës për burime njerëzore sipas profesionit, numri, kualifikimet dhe afatet, duke përfshirë edhe burimet e nevojshme financiare për realizimin e këtij planifikimi. Menaxhimi ekzekutiv dhe departamenti i burimeve njerëzore luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e planifikimit të burimeve njerëzore.

Planifikimi i burimeve njerëzore është një funksion menaxherial i planifikimit të burimeve njerëzore. Për të zbatuar planet në mënyrë efektive, duhet të përgjigjemi pyetjeve të mëposhtme :

- Sa njerëz na duhen për të arritur planet dhe synimet tona?
- Çfarë lloj njerëzish, aftësitë dhe njohuritë e të cilëve na duhen?
- Si të sigurojmë njerëzit e nevojshëm?

- Si të përgatisim punonjësit aktualë për nevojat dhe kërkesat e biznesit?

Rekrutimi i punonjësve është hapi i parë në sigurimin e burimeve njerëzore cilësore.

Në procesin e tërheqjes së personelit, duhet të përgjigjemi tre pyetjeve:

- Çfarë lloj njerëzish nevojiten?
- Ku t'i gjejmë?
- Si t'i gjejmë?

Kur i përgjigjemi pyetjes së parë, ne marrim parasysh katër pikëpamjet e përcaktuara brenda organizatës :

- struktura e moshës,
- kualifikimi,
- përvoja,
- vlerësimi i aftësive për shkak të progresit të mundshëm.

Rekrutimi është një proces i nxitjes –tërheqjes së kandidatëve të cilat kanë kualifikime dhe përgatitje e njohuri të cilat ata mund ti zbatojnë në ndërmarrje. Faza e rekrutimit ka për qëllim të sigurojë numër të mjaftueshëm i cili mundëson në masë të duhur zgjedhjen e kandidatëve më të mirë në një organizatë.

Ai përfshin:

- identifikimin e burimeve ekzistuese të kandidatëve dhe zhvillimin e tyre;
- kërkimi dhe identifikimi i burimeve të reja të kandidatëve;
- motivimi i llojit të duhur të kandidatëve për të aplikuar për një vend pune në organizatë;

- sigurimi i një ekuilibri të shëndetshëm midis burimeve të brendshme dhe të jashtme.

Procesi I seleksionimit është një proces i përcaktimit të kualifikimeve, përvojës, aftësive, njohurive të aplikantit për të përcaktuar përshtatshmërinë e tij për punën e aplikuar.

Kjo përfshin:

- zhvillimi i vendeve të lira të punës;
- krijimin dhe zhvillimin e teknikave të vlefshme dhe të besueshme të testimit;
- formulimin e teknikave të intervistimit;
- kontrollimin e referencave;
- vendosja e një politike dhe procedurë për ekzaminimin mjekësor;
- Në vendimmarje të përfshihen menaxherët e linjës

Gjatë zgjedhjes të kandidatëve nuk marrin pjesë vetëm ekspertët dhe stafi i burimeve njerëzore por gjithashtu marrin pjesë edhe drejtorët e atyre sektorëve që kërkojnë njerëz të rinj për të punësuar . Edhe pse të gjithë punojnë me të njëjtin qëllim, për të arritur kandidatët më të mirë, rolet dhe përgjegjësitë e tyre janë të ndara. Një nga problemet më të vështira me të cilat përballen një person është vlerësimi i karakteristikave të njerëzve, aftësive dhe cilësive të tyre.

Kualifikimet, shkathtësitë dhe qëndrimet janë aftësitë me të cilat individ arrin rezultate dhe kanë një rëndësi të madhe për kryerjen e detyrave të caktuara. Për t'u punësuar, një individ duhet të ketë aftësi të caktuara për një punë të caktuar. Gjatë procesit të përzgjedhjes, mund të zgjidhen kandidatët që plotësojnë të gjitha kërkesat për një pozicion të caktuar ose kandidatët për të cilët organizata do të ofrojë trajnim për një punë të caktuar.

Mirëpo, njëri nuk punësohet për të qëndruar në të njëjtën punë dhe në të njëjtin nivel. Ai vazhdimisht punon për të ngritur në detyrë dhe për të rritur njohuritë dhe

kualifikimet e tij. Këtë organizatat mund tua ofrojnë punëtorëve përmes trajnimeve dhe edukimit të punonjësve. Përzgjedhja profesionale e kandidatëve për ngritje në detyrë duhet të jetë e njëjtë me përzgjedhjen dhe vendosjen e njerëzve të rinj dhe kjo përfshin propozimin e kandidatëve, vlerësimin e cilësive të tyre, marrjen e vendimeve dhe monitorimin e zhvillimit të karrierës.

3. Përgjegjësitë e departamentit për menaxhimin e resurseve njerëzore në sektorin bankar

Roli i departamentit të burimeve njerëzore është të krijojë një klimë dhe kushte në të cilat menaxhmenti i gjithë bankës do të jetë në gjendje të balansojë kontributin individual dhe kolektiv të të gjithë punonjësve në suksesin afatshkurtër dhe afatgjatë të bankës.

Disa nga përgjegjësitë kryesore janë :

- Të jetë finansuesi dhe udhëheqësi kryesor i politikave të burimeve njerëzore të bankës.
- Të propozojë dhe të japë përgjigje për të ndryshuar këto politika dhe për të siguruar që politikat e zgjedhura të zbatohen në të gjithë bankën.
- Të kontribuojë plotësisht në përmbushjen e sfidave të biznesit me të cilat përballet banka duke mbështetur menaxherët e degëve në zhvillimin e vazhdueshëm të potencialit të punonjësve dhe krijimin e kushteve në të cilat të gjithë punonjësit janë të motivuar për të përmbushur qëllimet e bankës.
- Monitorimi i vazhdueshëm i strategjisë së bankës për të siguruar që politikat e burimeve njerëzore janë të përshtatshme dhe se numri i stafit dhe aftësitë e tyre mbështesin plotësisht strategjitë e dhëna.
- Të ofrojë një gamë të plotë të shërbimeve për punonjësit. Këto shërbime përfshijnë planifikimin e fuqisë punëtore, rekrutimin , shpërblimin , trajnimin dhe mirëqenien e punonjësve.

- Të mbështesë menaxherin e degës në udhëheqjen e punëve të përditshme në lidhje me fuqinë punëtore duke ofruar këshilla dhe konsultime për çështje që lidhen me menaxhimin e personelit dhe menaxhimin e performances.

Sigurisht që përgjegjësitë e mësipërme janë një pjesë e përgjegjëseve të sektorit të menaxhimit të burimeve njerëzore në sektorin bankar dhe kanë një rëndësi të veçantë në rezultatet e bankës.

4. Aspektet e menaxhimit të resurseve njerëzore në sektorin bankar

Menaxhmenti I resurseve njerëzore përfshin aktivitetet e mëposhtme që ndikojnë në natyrën e marrëdhënies midis punonjësve dhe bankës:

- ndikimi i punonjësve, të gjitha mënyrat e përfshirjes në procesin e vendimmarrjes në aktivitetet e biznesit;
- rrjedha e burimeve njerëzore janë të gjitha vendimet që vlejnë për punonjësit kur hyjnë, qëndrojnë dhe dalin nga banka;
- sisteme shpërblimesh të lidhura me sistemet e shpërblimeve materiale dhe jomateriale;
- sistemet e punës janë kushtet e punës dhe mënyra e organizimit të punës në nivelin e vendit të punës;
- Pajtueshmëria me të katër aspektet e zbatimit të MBNJ.

Resursi njerëzor është burimi më i rëndësishëm në sistemin bankar. Cilësia e burimeve njerëzore është një faktor bazë i cilësisë për të gjithë bankën.

Sidoqoftë, pavarësisht statusit të punonjësve, qofshin ata menaxherë, staf profesional apo administrativ ose profil tjetër i punonjësve, kujdesi për MBNJ është i rëndësishëm për të gjithë ata.

5. Konkluzione

Baza për një biznes të suksesshëm është menaxhimi i drejtë dhe efektiv i burimeve njerëzore. Ndryshe nga vitet e mëparshme, kur aktivet e prekshme përbënin pjesën më të madhe të tregut, sot shumica e aktiveve të korporatave janë pasuri të paprekshme, duke e bërë menaxhimin e burimeve njerëzore një nga faktorët më të rëndësishëm për suksesin e korporatave. Ndryshimet e tregut dhe teknologjisë vendosin kritere të ndryshme në organizatë.

Ndërsa gjatë shekullit njëzet e një organizatat lëvizin përpara, është bërë e qartë se menaxhimi efektiv i burimeve njerëzore është një burim kryesor i përparësisë konkurruese dhe madje mund të jetë faktori i vetëm më i rëndësishëm në performancën afatgjatë të një organizate. Kështu sot niveli i konkurrencës midis organizatave është rritur. Shumica e organizatave sot mund të kopjojnë teknologjinë, procesin e prodhimit dhe produktet. Mirëpo, menaxhimi i burimeve njerëzore është i vështirë për t'u kopjuar dhe kështu burimet njerëzore bëhen një avantazh unik konkurrues për çdo organizatë. Nga ana tjetër, shkalla e papunësisë është mjaft e lartë, gjë që krijon një konkurrencë të madhe midis kandidatëve që aplikojnë për vendet e lira të punës të kufizuara. Si pasojë e ndryshimeve të shpejta dhe kushteve specifike në ndërmarrjet tona, menaxhimi i burimeve njerëzore shihet jo vetëm si një faktor për suksesin e organizatave, por të të gjithë vendit.

Konkurrenca dhe vlera e organizatës varen nga mënyra e rekrutimit, përzgjedhjes, motivimit, shpërblimit, avancimit, zhvillimit dhe procesit të arsimimit të stafit.

Punonjësit cilësorë janë një nga faktorët kryesorë për funksionimin e suksesshëm të organizatës dhe për këtë arsye rekrutimi dhe përzgjedhja janë një nga aktivitetet më të rëndësishme. Përmirësimi i aftësive, njohurive dhe aftësive të punonjësve gjithashtu ka një ndikim në progresin e organizatës, dmth nëse organizata dëshiron të përparojë duhet të investojë vazhdimisht tek punonjësit e saj.

